

*Të mësojmë gjuhën amtare
dhe kulturën shqiptare* **1**




**IKBALE ISAKU
FATMIR XHEMALAJ**

**Msc. ANILA HASANI
Msc. ARTUR HASANI**

Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare

**Për nxënësit shqiptarë jashtë
Republikës së Shqipërisë**



MIRATUAR NGA MINISTERIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
2011

Titulli i librit:
Të mësojmë gjuhën amtare
dhe kulturën shqiptare 1

Autorë:
Gjuhë shqipe dhe letërsi: Ikbale ISAKU dhe Msc. Anila HASANI
Histori dhe gjeografi: Fatmir XHEMALAJ
Trashëgimi kulturore: Msc. Artur HASANI

Redaktor shkencor:
Prof. Shefik OSMANI

Redaktor letrar:
Prof. as. Dr. Murat GECAJ

Recensentë:
Musa VYSHKA
Ramiz DOKO

Arti kompjuterik:
Studio grafike "FILARA"

Punoi:
Tauland LLAKA

Botimi i parë:
FILARA, 2011

Botimi dytë (i përmirësuar):
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, 2021

BOTIME SHKOLLORE

© Qendra e Botimeve për Diasporën
Adresa: Rruga "Vilat Gjermane",
Vila Nr. 6, Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@qbd.gov.al
Web: <http://www.qbd.gov.al>



Përmbajtja

Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

- | | |
|---------------------|----|
| 1. "Atdheu" | 12 |
| 2. Himni i Flamurit | 13 |

LINJA **1** NJOH ALFABETIN E GJUHËS SHQIPE



- | | |
|--------------------------------------|----|
| 1. Alfabeti i gjuhës shqipe | 15 |
| 2. Shkronja e madhe e shtypit | 17 |
| 3. Shkronja e madhe e dorës | 18 |
| 4. Shkronja e vogël e shtypit | 19 |
| 5. Shkronja e vogël e dorës | 20 |
| 6. Zanoret e gjuhës shqipe | 21 |
| 7. Punë praktike: Rretho zanoret | 23 |
| 8. Bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe | 25 |
| 9. Punë praktike: Emërto dhe shkruaj | 27 |

Përmbajtja

LINJA 2 FLAS DHE LEXOJ NË GJUHËN SHQIPE



1. Lexoj përmes figurës **30**
2. Lexoj fjalët në rrokje **31**
3. Lexoj fjali të thjeshta përmes figurave **32**
4. Flas për shkollën time **33**
5. Emërtoj pjesët e trupit **34**
6. Prezantoj veten **35**
7. Unë jetoj në familje **37**
8. Ngjyrat e ylberit **38**

LINJA 3 NJOHURI PËR KULTURËN DHE GJUHËN SHQIPE



1. Emrat e përgjithshëm e të përveçëm, drejtshkrimi i tyre **41**
2. Zemra e Nënë Terezës **45**
3. Gjergj Elez Alia (legjendë) **46**
4. Mbiemri dhe llojet e tij **47**

Përmbajtja

5. Përshkruaj	49
6. Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm	50
7. Fjalìa, paragrafi , teksti	52
8. Pikëzat e ujit të detit	55
9. Macja dhe Hëna (përrallë)	56
10. Përemri vetor	59
11. Borëbardha dhe shtatë xhuxhat (përrallë)	61
12. Shkruaj kartolina, uroj	63
13. Folja. Foljet kam, jam	64
14. Kohët e foljes. Koha e tashme, e shkuar, e ardhme	65
15. Bariu i vogël dhe Skënderbeu (rrëfenjë)	69
16. Fjalìa dëftore dhe përdorimi i pikës (drejtshkrim)	71
17. Dheu është flori (rrëfenjë)	74
18. Fjalë të mençura të popullit	76
19. Fjalìa pyetëse dhe përdorimi i pikëpyetjes (drejtshkrim)	77
20. Kësulëkuqja (përrallë)	79
21. Thethi	81
22. Baba Viti dhe fëmijët e tij	83
23. Shkruaj një letër	85
24. Fjalìa pohore dhe mohore	86
25. Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (drejtshkrim)	87



Përmbajtja

26. Njollëzat e Njomëzës	89
27. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit	90
28. Shkruaj një faqe ditari	91
29. Fjalët që përbëjnë grupet (mb, nd, ng)	92

LINJA 4 I KËNDOJ ATDHEUT DHE GJUHËS SHQIPE



1. Djali dhe shqiponja (poezi)	95
2. Sa të dua o Shqipëri! (poezi)	97
3. Gjuha shqipe (poezi)	98
4. Komunikoj në largësi	101
5. Kush e gjen?	103

Përmbajtja

Histori e shqiptarëve

LINJA 1 IDENTITETI SHQIPTAR



PORTRET: SHPALLJA E PAVARËSISË - VLORË 1912
ISA BOLETINI puth flamurin



- | | |
|--------------------|-----|
| 1. Pema e familjes | 106 |
| 2. Festa kombëtare | 108 |
| 3. Shqiptarët | 110 |

LINJA 2 SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË



- | | |
|--------------------------------|-----|
| 1. Vendlindja e të parëve tanë | 112 |
|--------------------------------|-----|

Përmbajtja

LINJA 3 KULTURA DHE SHOQËRIA



1. Të gjithë të ndryshëm,
të gjithë të barabartë

116

GJEOGRAFI: TROJE KU BANOJNË SHQIPTARË NDËR SHEKUJ

LINJA 1 IDENTITETI SHQIPTAR



1. Shqipëria dhe Kosova

118

Përmbajtja

LINJA 2 SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË



1. Veçoritë natyrore të viseve shqiptare **125**

LINJA 3 KULTURA DHE SHOQËRIA



1. Prejardhje e ndryshme,
jetë e përbashkët **131**

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve

LINJA

1

IDENTITETI SHQIPTAR



1. Flamuri simboli ynë kombëtar **135**
2. Lojërat popullore shqiptare **136**
3. Rrënjët e mia dhe të familjes sime **137**
4. Vegla muzikore popullore shqiptare **138**
5. Veprimtaritë tradicionale kombëtare për fëmijë **142**
6. Festalet e këngës për fëmijë **143**
7. Mjedisi dhe peizazhi shqiptar **144**
8. Veshjet popullore shqiptare **146**
9. Kostumet popullore shqiptare **148**
10. Motive tradicionale shqiptare **150**
11. Kostume karakteristike të folklorit shqiptar **152**


Përmbajtja

LINJA 2 SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË



1. Shqipëria përmes trashëgimisë shpirtërore **153**
2. Figura të shquara të historisë shqiptare **155**

LINJA 3 KULTURA DHE SHOQËRIA



1. Përralla, gjëgjëza, fjalë të urta **157**
2. Fjalëshpejta **159**
3. Festat tradicionale: Dita e Verës **160**
4. Këngët legjendare shqiptare **161**
5. Heronjtë e këngëve legjendare **163**
6. Muzika popullore **164**

Atdheu

Atdheu,

*Kryefjala,
e të gjitha fjalëve.*

*Dashuria,
e të gjitha dashurive.*

Dheu i mëmës e i atit.

*Dheu,
që më jep emrin e madh,
Shqiptar*

(I. Isaku)






HIMNI I FLAMURIT





















Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshirë, e një qëllim.
Të gjithë, atij duke ju betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet,
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk frigohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!












A B C




Linja 1

Njoh alfabetin e gjuhës shqipe


				
a	b	c	ç	d
				
dh	e	ë	f	g
				
gj	h	i	j	k
				
l	ll	m	n	nj

				
o	p	q	r	rr
				
s	sh	t	th	u
				
v	x	xh	y	z
				
zh				



Shkronja e madhe e shtypit

A	N
B	NJ
C	O
Ç	P
D	Q
DH	R
E	Rr
Ë	S
F	SH
G	T
GJ	TH
H	U
I	V
J	X
K	XH
L	Y
LL	Z
M	ZH



Shkronja e madhe e dorës

A _____ N _____

B _____ Ni _____

C _____ O _____

Ç _____ P _____

D _____ Q _____

Dh _____ R _____

E _____ Rr _____

Ë _____ S _____

F _____ Sh _____

G _____ T _____

Gj _____ Th _____

H _____ U _____

I _____ V _____

J _____ X _____

K _____ Xh _____

L _____ Y _____

Ll _____ Z _____

M _____ Zh _____

Linja 1

Njoh alfabetin e gjuhës shqipe



Shkronja e vogël e shtypit

a	n
b	nj
c	o
ç	p
d	q
dh	r
e	rr
ë	s
f	sh
g	t
gj	th
h	u
i	v
j	x
k	xh
l	y
ll	z
m	zh



Shkronja e vogël e dorës

a

n

b

nj

c

o

ç

p

d

q

dh

r

e

rr

ë

s

f

sh

g

t

gj

th

h

u

i

v

j

x

k

xh

l

y

ll

z

m

zh

➔ Zanoret e gjuhës shqipe

Nxirr nga shporta 7 tinguj



A-a



_ r r _



ll _ mb _



d _ r _



ç _ dr _

E-e



_ r _



_ _ r _ pl _ n _



sh _ g _



_ l _ f _ nt _

Ë-ë



h _ n _



n _ n _



kr _ h _ r _



r _ r _

Linja 1

Njoh alfabetin e gjuhës shqipe








I-i	 _r_q_	 fl_m_r_	 l_m_n_	 d_ll_
O-o	 d_r_	 shq_p_nj_	 z_g_	 gj_th_
U-u	 rr_sh_	 _n_z_	 _jk_	 l_p_r_
Y-y	 _lb_r_	 _ll_	 m_l_	 p_ll_



Punë praktike: Rretho zanoret

			
çanta	çadra	motra	macja
			
qeni	televizori	portokalli	fletorja
			
nëna	dritarja	djali	ketri
			
iriqi	shtëpia	libri	pjepri

Punë praktike: Rretho zanoret

 topi	 portokalli	 ariu	 ora
 ulliri	 lepuri	 bufi	 kukulla
 ylberi	 dylbia	 fyelli	 fytyra

Lexoj zanoret

e ë u i a o y

e ë u i a o y



DETYRË

Shkruaj në fletore zanoret e gjuhës shqipe.

















Bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe


a) Numëro. Sa bashkëtingëllore ka gjuha shqipe?

b) Rretho bashkëtingëlloret dyshe.

B b, C c, Ç ç, D d, **Dh dh**, F f, G g, Gj gj, H h,
 J j, K k, L l, Ll ll, M m, N n, Nj nj, P p, Q q,
 R r, Rr rr, S s, Sh sh, T t, Th th, V v, X x, Xh xh,
 Z z, Zh zh

Gjej dhe rretho bashkëtingëlloret dyshe.





















Dh-dh Gj-gj Ll-ll Nj-nj	 dhelpra	 dhëmbi	 dardha	 dhia	 monedha
	 gjyshi	 gjeli	 gjethja	 petulla	 llamba
	 akullorja	 pëllumbi	 shqiponja	1 njëshi	 arushi



Bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe



Gjej dhe rretho bashkëtingëlloret dyshe.

<p>Rr-rr Sh-sh Th-th Zh-zh Xh-xh</p>	 rrota	 karrota	 burri	 karroca
	 rrushu	 shishja	 pisha	 shkëmbi
	 gjethja	 rrethi	 thana	 thëllëza
	 xhepi	 zinxhiri	 xhaketa	 xhinset
	 gozhda	 zhaba	 plazhi	 zhavorri



Lexo dhe mëso shkronjat e dorës.


dh gj ll nj rr sh th xh zh

Dh Gj Ll Nj Rr Sh Th Xh Zh





















DETYRË

Shkruaj në fletore alfabetin e gjuhës shqipe dhe mësoje përmendsh.



















Punë praktike: Emërtoj e shkruaj


 <p>A _____</p>	 <p>b _____</p>	 <p>c _____</p>	 <p>ç _____</p>
 <p>d _____</p>	 <p>dh _____</p>	 <p>e _____</p>	 <p>ë _____</p>
 <p>f _____</p>	 <p>g _____</p>	 <p>gj _____</p>	 <p>h _____</p>
 <p>i _____</p>	 <p>j _____</p>	 <p>k _____</p>	 <p>l _____</p>
 <p>ll _____</p>	 <p>m _____</p>	 <p>n _____</p>	 <p>nj _____</p>


Linja 1

Njoh alfabetin e gjuhës shqipe

 o _____	 p _____	 q _____	 r _____
 rr _____	 s _____	 sh _____	 t _____
 th _____	 u _____	 v _____	 x _____
 xh _____	 y _____	 z _____	 zh _____

UNË LEXOJ





Lexoj përmes figurës

dielli




hëna



qielli



deti



djali




vajza



shkolla



nxënësi



mësuesja



rruga



semafori



makina



dhia



dhoma



shtëpia









DETYRË

Nënvizo me blu bashkëtingëlloret dhe me të kuqe zanoret.

Mësoj hap pas hapi




Lexoj fjalët në rrokje



DETYRË

Ndaj në rrokje këto fjalë: pema, shkalla, gjyshja, batanija, qumështi, kukulla, letra, flutura.



Lexoj fjali të thjeshta përmes figurave



mami



lan



rrobat



Genti



hedh



topin



gjyshi



lexon



gazetën



Diellza



këndon





në skenë




DETYRË

Formo fjali me fjalët në petalet e luleve.




Mësoj hap pas hapi



Flas për shkollën time


► Kuptoj e flas rreth fotografive



Si është shkolla jote?



Cilat janë orenditë e klasës tënde?



Cilët janë nxënësit e klasës tënde?




Çfarë mëson në klasë?



DETYRË

Përshkruaj klasën tënde.



Emërtoj pjesët e trupit

► Cilat janë pjesët e trupit të njeriut?

Emërto edhe pjesë të tjera të trupit të njeriut.

Syri



Koka

Kraharori

Krahu

Dora

Gjuri


Këmba



DETYRË

Emërto e shkruaj pjesë të trupit tënd.

Lexoj dhe flas



Prezantohet veten

1

Unë jam **Bledari**.



2

Jam një i gjatë.



3

Kam të blertë.



4

i kam gështenjë.



5

Me pëlqen



6

Luaj çdo të shtunë.



7

Ngjyra ime e parapëlqyer është



8

Veshja që përdor është



9

Ushqimi që më pëlqen më shumë është



► Cila jam unë? Prezantoj veten.

1

Unë jam **Teuta**.



2

Unë jam 8 vjeç.



3

Unë kam  të verdhë.

5

Mua më pëlqen



4

Mua më pëlqen të lexoj



Shkruaj një listë dëshirash si Teuta.



DETYRË


Prezanto dhe ti veten tënde.

Lexoj dhe flas



Unë jetoj në familje


Familja e Ilirit



gjyshi – gjyshja



mami – babi



fëmijët

Familja ime ka gjashtë vetë.

Cilët janë pjesëtarët e familjes tënde?

Unë kam _____

Unë kam _____

Unë kam _____


Unë kam _____

Unë kam _____



DETYRË

Trego diçka të bukur për familjen tënde.



Ngjyrat e ylberit

► Mësoj të dalloj ngjyrat.



Ylberi ka shumë ngjyra. Ai del në kohë me diell, pas shiut. Ai është i bukur dhe i pëlqyeshëm për fëmijët. Për ylberin tregojnë shumë ngjarje tërheqëse. Ylberi ka shtatë ngjyra.

► Cilat janë ngjyrat e ylberit? Emërto.

- a) _____ b) _____ c) _____ d) _____
e) _____ f) _____ g) _____ h) _____

► Kur del ylberi? Rretho.

- a) Në kohë me diell. b) Pas shiut. c) Pas borës.

► Shkruaj dy fjali për ylberin.

Lexoj dhe flas

▶ DETYRË



▶ Rendit ngjyrat që mësove.

1. e kaltër

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

6. _____

7. _____

➔ Emërtoj ngjyrat.

Shkruaj disa emra që tregojnë ngjyrë.
Vizato ylberin.

Lexoj: Përralla Legjenda Tregime





Emrat e përgjithshëm e të përveçëm, drejtshkrimi i tyre


Një ditë një burrë hyri në një dyqan për të kërkuar një dhuratë për të birin, i cili do të festonte ditëlindjen e tij të nëntë. Në vitrinë ai pa një çetë ushtarësh prej plumbi. Ishin të gjithë të njëjtë, përveç njërit të cilit i mungonte njëra këmbë. Pasi pa lodrat e tjera, ai vendosi të blinte ushtarët prej plumbi.

► Fjalët me ngjyrë janë emra. Shkruaji në fletore.

Emrat tregojnë: sende, objekte, njerëz, kafshë, vende, por edhe ndjenja, si për shembull: gëzim, habi, frikë etj.



► Emërto figurat.





Ushtrohem

- ▶ **Shkruaj emra që tregojnë lule, objekte dhe njerëz.**

▶ lule	▶ objekt	▶ njerëz
manushaqe	tryezë	djalë
.....
.....

- ▶ **Shiko me kujdes figurën dhe shkruaj emrin përkatës.**



- ▶ **Mendo dhe shkruaj.**

a) Emra që tregojnë kafshë ose njerëz: _____

b) Emra sendesh që përdor çdo ditë: _____

Njohuri gjuhësore

► Dalloj emrat e përgjithshëm e të përveçëm.

Ndeza **dritën** në dhomën time



Drita po lexon një libër.



Lart ndrin një **yll**.



Vëllai im quhet **Ylli**.



Shqiponja fluturon në male.

Tezja ime quhet **Shqiponja**.



Kjo **lule** është e kuqe.



Lulja shëtit me biçikletë.

► Shiko me vëmendje përdorimin e dyfishtë të të njëjtit emër.

Kuptoj

I njëjti emër përdoret në dy raste të ndryshme.

Në rastin e parë emri tregon një send, një bimë, një kafshë etj.

Këto lloj emrash quhen **emra të përgjithshëm**.

Në rastin e dytë emri tregon një njeri që dallohet nga të tjerët, prej emrit të tij.

Këto lloj emrash quhen **emra të përveçëm**.

Mbaj mend

Emrat e përgjithshëm shkruhen me shkronjë të vogël.

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

1. Lidh me shigjetë emrin e përgjithshëm me emrin e përveçëm.

qyteti	Shqipëria
shteti	Prishtina
mësuese	Arta

2. Korrigjo fjalët e shkruara gabim.


Mësuese anila	qyteti tirana
Nxënës iliri	Lumi vjosa
Shkolla 1 maji	Kukulla pinoku

3. Ndaji në dy kolona emrat e përgjithshëm e të përveçëm.

Lumi	Vjosa	piktori	Valbona
qeni	1 Maji	Drita	Abetare
Astriti	nxënës	drita	fletore
makina	Agimi	Peja	zemra

4. Plotëso.

- Emra që tregojnë njerëz:
- Emra që tregojnë qytete:
- Emra që tregojnë sende:
- Emra që tregojnë kafshë:
- Emra që tregojnë shtete:



Zemra e Nënë Terezës



Babai i tregoi Zamirës për shenjtoreshën shqiptare të quajtur Nënë Tereza. Një grua e shenjtë, me trup të vogël, por me zemër të madhe. Nënë Tereza gjithë jetën e saj ua kushtoi njerëzve të varfër. Ajo ndihmonte të sëmurët, të braktisurit, të varfërit, pleqtë e fëmijët, të gjithë të vuajturit e botës. Sa e sa zemra fatkeqe ka qetësuar Nënë Tereza me sjelljen e saj të ëmbël. Ne jemi krenarë që Nënë Tereza ishte shqiptare.

Plotëso fjalitë.

E dua Nënë Terezën, sepse _____
(ndihmoi, fëmijët e botës)

E dua Nënë Terezën, sepse _____
(zemër të madhe)

E dua Nënë Terezën, sepse _____
(është shqiptare, e dashur)




Shkruaj në fletore: Nënë Tereza është bijë e tokës shqiptare.



DETYRË

1. Pyet prindërit për Nënë Terezën.
2. Shkruaj disa fjali për Nënë Terezën.



Gjergj Elez Alia

(Legjendë)



Trim mbi trima kishte qenë gjithmonë Gjergj Elez Alia...Të gjithë armiqtë ai i kishte shtrirë përtokë, pa frymë. Por në lufrat e shumta trimi ynë kishte marrë nëntë plagë në trup dhe kishte nëntë vjet i sëmurë. Motra i rrinte ditë e natë mbi krye. Ai i duronte si burrë dhembjet e plagëve.

Vitin e nëntë doli nga deti një bajloz i zi, trim i fortë, më i lig nga gjithë bajlozët e tjerë. Bajlozi vriste ditë për ditë, digjte javë për javë një krahinë.

Gjergj Elez Alia s'dinte gjë. Askush s'vinte t'i kërkonte ndihmë, sepse e dinte se s'ngrihej dot që të dilte as te pragu i derës.

Kur i erdhi radha shtëpisë së Gjergjit, motra, qau me lot, tha:

- Pse vallë s'shembet kjo kullë të na zërë brenda të vdekur? Vdekja është më e ëmbël, moj e zeza nënë, se sa jeta pa nder!

Gjergji i tha:

- Pse qan, moj motër? Pse ma thyen kaq fort zemrën?

Atëherë ajo i tregoi për bajlozin.

Gjergji i harroi të nëntë plagët e tij, u ngrit e doli të luftonte bajlozin e zi.

Bajlozi ishte veshur me parzmore të rënda hekuri, kish vënë në kokë përkrenare çeliku, e kishte shpatë të gjatë. Edhe kalin e kish ngarkuar me pllaka hekuri. Tundej dheu ku shkelte. Sapo e pa Gjergji thirri: - Bëhu gati, bajloz, se të ka ardhur dita e fundit! Këtu i thonë Gjergj Elez Alia!

I lëshuan kuajt vrap në fushën e luftës tym më tym.

Gjergji e hodhi topuzin e vet dhe e qëlloi bajlozin në ballë. Bajlozi vdiq menjëherë.

Pasi e vrau bajlozin e zi, trimi u kthye fitimtar në shtëpi.

(Përshtatje)

1. Ritrego legjendën me fjalët e tua.

2. Diskuto në klasë: Cili nga personazhet ju pëlqen? Pse?

Gjergji	—	trim	Bajlozi	—	frikacak
	—	luftëtar		—	i pandershëm
	—	i ndershëm		—	i pashpirt
	—	i drejtë		—	i padrejtë
	—	i zoti		—	i zoti




DETYRË

a) Vizato një nga personazhet.

b) Përpiquni të luani në role legjendën.

Njohuri gjuhësore



Mbiemri dhe llojet e tij

► Dalloj mbiemrin.

Në kështjellë valëvitej **flamuri i kuq** me **shqiponjë të zezë**.

Fjalët i kuq, e zezë tregojnë si janë flamuri dhe shqiponja. Fjalët që tregojnë cilësi quhen mbiemra.

► Shkruaj cilësi të figurave të dhëna.

djalë –



vajzë –



qiell –



pyll –



diell –



lule –



Ushtrohem

1. Plotësoni fjalitë me mbiemrat e dhënë: *trim, krenar, e rëndë, e mprehtë, e lashtë, e mbrojtur, historik, i bukur.*

- Skënderbeu ishte një burrë _____ dhe _____.
- Shpata e Skënderbeut ishte _____ dhe _____.
- Kalaja e Krujës është _____ dhe _____.
- Qyteti i Prizrenit është _____ dhe _____.

2. Formo fjali me mbiemrat: *i kuq, i qeshur, shtatlartë, e shkathët, guximtare.*



► Diktim

Skënderbeu ishte luftëtar me shtat të lartë e me krahë të fortë. Shpata e tij ishte e gjatë, e përkulur dhe shumë e rëndë. Ai kishte edhe një shpatë më të vogël e të drejtë. Skënderbeu luftoi 25 vjet rresht kundër turqëve osman dhe fitoi. Ai është heroi legjendar i Shqipërisë. Ne jemi krenarë që kemi një hero si Skënderbeu.

Nënvizo mbiemrat në tekstin e dhënë.



Diskutoj

Thuaj mbiemra me kuptim të kundërt nga ata që nënvizove.



Përshkruaj sendet

→ Libri është:

→ Lapsi është:

→ Çanta është:

Njohuri gjuhësore



Përshkruaj

► Dhoma ime

Unë kam një dhomë shumë të bukur. Muret e saj janë lyer me ngjyrë të kaltër. Në njërin anë kam garderobën me dy ngjyra: portokalli dhe të blertë. Në anën tjetër është krevati im i bardhë. Tapeti është m vija blu dhe i butë. Perdet e dhomës janë të bardha me trëndafila. Në cep të dhomës kam raftin tim të librave. Sa mirë ndihem në dhomën time.



Diskutoj

1. Shih figurat dhe trego cilësi të tyre.



2. Zgjidh dhe përshkruaj me fjalët e tua: dhomën tënde, parkun e lodrave ose diçka tjetër që ju pëlqen.

► **Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm**



Ushtrohem

► **Shiko figurat dhe lexo.**

Lopa



shtëpiake

laramane

ripërtypëse

Fusha



e blertë

e gjerë

e bukur

► **Vër re ndryshimin midis dy grupeve të mbiemrave.**

Mbiemrat e grupit të parë janë mbiemra të panyjshëm.

Mbiemrat e grupit të dytë janë mbiemra të nyjshëm.

► **Plotëso tabelën.**

mbiemri	i nyjshëm	i panyjshëm
guximtar		+
i mirë		
e shijshme		

Njohuri gjuhësore

► **Grupo sipas formimit mbiemrat e mëposhtëm.**


të mëdha, e shkathët, i dashur, laraman, të vegjël, shembullor, e lartë, i mërzitur, të gëzuara, fluturake, të ëmbla, të qeshura, xixëlluese.

► **Për secilën nga fjalët vendosni, si në shembull, një mbiemër të nyjshëm e një të panyjshëm.**

shtëpi	<u>e lartë</u>	<u>blu</u>
qiell	_____	_____
dele	_____	_____
fletore	_____	_____
vajzë	_____	_____
nxënëse	_____	_____

► **Shkruaj sa më shumë mbiemra që tregojnë cilësi të emrave të dhënë.**

shkollë	_____
lule	_____
qytet	_____
djalë	_____
kërcimtar	_____
fshat	<u>malor, turistik, i gjelbëruar</u>



Fjala, paragrafi, teksti

Fjalët lidhen me njëra-tjetrën dhe formojnë fjali.

Disa fjali së bashku përbëjnë një paragraf. Paragrafët fillohen, gjithmonë, me kryeradhë.

Fjalitë dhe paragrafët, duke u lidhur së bashku, formojnë tekstin.

Fjalët dhe fjalitë bashkohen sipas një kuptimi logjik.



Ushtrohem

1. Renditi fjalitë sipas radhës.

Laj dhëmbët dhe vishem.

Ha mëngjes e nisem për në shkollë në orën 7:00.

Në mëngjes unë çohem herët.

2. Rendit fjalitë në mënyrë logjike që të formojnë një tekst.

1. Babi më qortoi mbrëmë.
2. Nuk i thashë të vërtetën mësueses.
3. Theva pa dashje vazën e luleve.
4. Premtova se nuk do ta përsëris më.

3. Në pjesët e mëposhtme janë ngatërruar dy tekste. Ndaji si duhet dhe shkruaji në fletore.

- Mami gatuan kekun që më pëlqen më shumë.
- Atij i pëlqen shumë të luajë me mua.
- Në fund e di që do të më gëzojë me kekun e bërë.

- Qeni im e ka emrin Lesi.
- Ka bërë rrëmujë të madhe dhe është lodhur shumë.
- Unë e pastroj gjithmonë qenin.
- Kur vij nga shkolla më pret me padurim.



DETYRË

Zgjidh një nga titujt e mëposhtëm dhe krijo një tekst.

a. "Atdheu im".

b. "Shëtitje me klasën".



Njohuri gjuhësore

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe trego si lidhen pjesët e tij.

Në një kodrinë pranë pyllit, jetonte një fis i madh milingonash. Ato ishin punëtore dhe shkonin shumë mirë me kafshët dhe shpendët që banonin rreth e rrotull.

Një ditë prej ditësh një derr i egër i zi doli nga pylli, ndali mbi kodrinë, u shtri dhe filloi të ngrohej në diell. Ai nuk sillej mirë me të tjerët. Nuk kishte shok asnjë nga banorët e pyllit. Ndërkohë milingonat e palodhura shkonin e vinin nga foleja, sepse po mblidhnin ushqim për në dimër.

- Dëgjoni moj milingona, - thirri derri me inat. - Unë po fle dhe nuk dua asnjë zhurmë.



Shih tekstin me vëmendje.

Teksti është formuar nga bashkimi i fjalive. Ashtu si fjalët, edhe fjalitë duhet të kenë kuptim që të lidhen me njëra-tjetrën.

Teksti ndahet në pjesë më të shkurtra që quhen **paragrafë**. Çdo pjesë e paragrafit fillon me kryeradhë.



Ushtrohem


1. Sa paragrafë ka përralla e mëposhtme? Nga sa fjalë përbëhet secili prej tyre? A fillon çdo paragraf me kryeradhë?
2. Radhiti paragrafët saktë që të formojnë një tekst.

Disa fshatarë po punonin në fushë. Në mesditë u ulën në hijen e një lisi të çlodheshin e të hanin drekën. Njëri prej tyre, kur pa që tërë trungun e lisit kishte pushtuar dredhëza, e shkuli atë me gjithë rrënjë.

Në pranverë, ajo mbiu përsëri në të njëjtin vend. Lisi dhe pemët e tjera e kishin harruar. Dredhëza e dinte se nuk mund të hidhte shtat e vetme, ndaj filloi t'i lutej lisit përsëri për ndihmë. Atëherë lisi u kujtua për të.

- Kjo nuk i duhet askujt, - tha.

- Mirë ia bëre! - ia kthyen shokët. Brenda pak ditësh dredhëza u fishk e u tha. Zëri i saj nuk u dëgjua më.



Njoh natyrën



Pikëzat e ujit të detit

Pikëzat e ujit të detit u mërzitën duke u përkundur nga dallgët.

Dielli u tha: - Ejani tek unë!

Pikëzat u bënë të lehta dhe u ngjitën lart, drejt qiellit. Por, sa më shumë ngjiteshin, aq më shumë ndienin të ftohtë. U përqaftuan me njëra-tjetrën dhe formuan një re të bukur, të bardhë. Reja e bardhë takoi re të tjera dhe bashkë formuan një re të zezë.

Lart bënte ftohtë. Reja e zezë filloi të qajë dhe u kthye në shi. Pikëzat ranë mbi bar dhe i thithi toka. Ecën e ecën poshtë tokës, derisa gjetën një të çarë dhe dolën jashtë, në një burim. Rrodhën nëpër lëndina me bar e me lule dhe u bashkuan me përroin. Vrapuan me të derisa u takuan me lumin. Bashkë me lumin rendën nëpër gryka malesh, nëpër fusha dhe, më në fund, u gjendën përsëri në det.

(“Kutia magjike”, P. Bertola)

Dukuri natyrore



Diskutoj

- . Pse ishin mërzitur pikëzat e ujit?
- . Ç'bënë ato kur i thirri dielli?
- . Çfarë formuan pikëzat e ujit?
- . Çfarë ndodhi me renë?
- . Kë takuan pikëzat e vogla?
- . Ç'ndodh më tej?
- . Ritrego ngjarjen.



DETYRË

Përshkruaj një ditë me: shi, borë ose diell.



Përshkruaj qytetin ose fshatin tënd në një ditë me diell.



Macja dhe Hëna

(Përrallë)



Toto nuk ka as



, as miq. Ai ka

vetëm



Natën Toto luan me



Sa bëhet natë Totoja i thotë asaj: Mirëmbrema, Hënë. A luajmë?

Hëna tund kokën. - Po, luajmë.



hipën në mur, në

çati dhe



e ndjek nga pas.



hyn në



të

lahet. Macja habitet. Ç'bën? Po lahes?



nuk flet. Atëherë

Lexoj



hyn në



e pret mbi çati. Maçoku

Toto gjen një kavanoz me qumësht. Fut kokën të pijë qumësht

dhe koka i mbetet brenda në



Toto përplaset me



e bën potere.



e



zgjohen

Ato panë nën



Toton. Ata u afruan dhe e përkëdhelën.

Maçoku u lumturua.

– O Hënë! Po më përkedhelin. Atëherë s'iki këtej.
(Kërr...! Kërr...!) Ah, moj Hënë, sa të mirë janë!
Natën e mirë, o Hëna ime!



Kuptoj përrallën.

1. A kishte shtëpi e shokë maçoku?
2. Me kë luante ai?
3. Çfarë i ndodhi një natë?
4. Pse u lumturua Totoja?



Diskutoj

A të pëlqejnë kafshët?

Po.

Jo.

Pse? _____



Kuptoj fjalët.

kavanoz - enë prej qelqi me grykë të ngushtë.

potere - zhurmë e madhe.



DETYRË

Me ndihmën e mësueses, luajeni përrallën në role.

Njohuri gjuhësore



Përemri vetor

Unë jam një



Ne jemi disa



Ti je një



Ju jeni disa



Ai është një



Ata janë disa



Ajo është një



Ato janë disa



Mbaj mend

Përemri vetor **ai** përdoret për gjininë mashkullore.
Përemri vetor **ajo** përdoret për gjininë femërore.

Kuptoj

Përemri vetor zë vendin e një emri.
Ai përdoret në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Përemri vetor ka tre veta për numrin njëjës dhe tre veta për numrin shumës.

Kuptoj

Përemri vetor **ai** përdoret për numrin njëjës, gjinia mashkullore.

Përemri vetor **ajo** përdoret për numrin njëjës, gjinia femërore.

Përemri vetor **ata** përdoret për numrin shumës, gjinia mashkullore.

Përemri vetor **ato** përdoret për numrin shumës, gjinia femërore.



Ushtrohem

Nxirr nga shporta përemrin vetor që duhet.

1. _____ jam në klasën e parë.
2. _____ je në klasën e dytë.
3. _____ është nxënës shumë i talentuar.
4. _____ lexon bukur shqip.
5. _____ i respektojmë prindërit tanë.
6. Po _____ ku do të pushoni sivjet?
7. _____ luajnë futboll çdo fundjavë.
8. _____ i duan shumë gjyshet.



Përshkruaj veten dhe shokun/shoqen tënde, duke përdorur përemra vetorë. Nënvizoz përemrat vetorë.



DETYRË

Formo disa fjali me përemra vetorë të ndryshëm.

Borëbardha dhe shtatë xhuxhat

(Përrallë)

Një herë e një kohë, në një Mbretëri lindi një vajzë shumë e bukur me flokë të zinj dhe me lëkurë të bardhë. Mbreti dhe Mbretëresha, të mahnitur nga bukuria e vajzës së tyre të vogël, e quajtën atë Borëbardha.

Lumturia nuk zgjati shumë. Mbretëresha u sëmur dhe vdiq. Pak kohë më pas, Mbreti u martua përsëri. Mbretëresha e re ishte një grua e bukur, por shumë e keqe. Çdo natë, para se të shkonte në shtrat, ajo shikonte pasqyrën magjike dhe e pyeste:

- Pasqyrë, moj pasqyrë, a ka më të bukur se unë?

Dhe pasqyra, që nuk gënjente kurrë, i përgjigjej:

- Ju jeni më e bukura zonja Mbretëreshë.

Një natë, Mbretëresha u ul para pasqyrës magjike dhe, e pyeti si zakonisht:

- Pasqyrë, moj pasqyrë, a ka më të bukur se unë?

Dhe pasqyra, që nuk gënjente kurrë, iu përgjigj:

- Po, zonja Mbretëreshë, vërtet ka. Borëbardha!

Ajo kërkoi t'i sillnin gjahtarin më të mirë të Mbretërisë dhe i tha:

- Të urdhëroj të marrësh Borëbardhën e ta çosh në pyll dhe ta vrasësh.

Gjahtarit i erdhi keq për Borëbardhën dhe i tha:

- Vrapo, vrapo sa më larg, atje ku mbretëresha nuk të gjen dot kurrë.

Borëbardha vrapoi shume derisa gjeti një kasolle të vogël, si shtëpizë kukullash. Shtëpiza ishte e pistë dhe shumë rrëmujë. Ajo e pastroi. Shtëpia shkëlqente e tëra.

Aty banonin shtatë xhuxhë që punonin në një minierë. Kur mbërritën, ata thirrën:

- Çfarë ka ndodhur këtu?

Në dhomën e gjumit flinte një vajzë e bukur.

Të nesërmen, më i moshuari nga xhuxhët i tha Borëbardhës:

- Mos ia hap derën askujt!

Njerka i bëri pyetjen e zakonshme pasqyrës:

- Pasqyrë, moj pasqyrë, a ka më të bukur se unë?


Dhe pasqyra që nuk gënjente kurrë, iu përgjigj:

- Borëbardha, zonja Mbretëreshë. Ajo është gjallë dhe më e bukur se ju.

Mbretëresha e keqe përgatiti lëng helmues dhe ngjeu në të mollën më të kuqe e më të bukur. Ajo u shndërrua në një plakë trupvogël dhe shkoi te Borëbardha.

- Mirëdita, vajzë! - tha zonja plakë. - A dëshiron një mollë të shijshme të porsakëputur nga pema?

Ajo kafshoi mollën dhe u shemb përdhe. Xhuxhët e vegjël kujtuan se ajo vdiq. Ata i ndërtuan asaj një arkivol prej xhami dhe po qanin. Një princ kaloi aty afër dhe kur e pa aq të bukur e puthi. Borëbardha u zgjua. Ajo dhe princi u martuan dhe jetuan të lumtur përgjithmonë.





Flasim për personazhet

1. Si është princi?
2. Si është Borëbardha?
3. Si janë xhuxhat?
4. Si vepron njerka?

Diskutoj

1. Në sa paragrafë ndahet përralla e mësipërme? Përcaktoji ata.
2. Vizato sipas dëshirës, njërin nga personazhet e përrallës.
3. Ndani përrallën në role dhe vëreni në skenë.



Shkruaj

➔ Shkruaj kartolina, uroj



*Gëzuar Vitin e Ri!
Qoftë një vit i mbarë dhe
sjelltë në të gjitha familjet
tona shumë lumturi!*




DETYRË

Shkruaj një kartolinë urimi.

Linja 3

Njohuri për kulturën dhe gjuhën shqipe



Folja. Foljet kam, jam

Një pasdite arriti në fermë një rosë e moshuar, e cila u tregua e përzemërt me Rosakun. Por kur i erdhi ora të largohej, ajo e gjeti atë duke qarë, sepse ndihej i përjashtuar.

– Ti nuk je i shëmtuar, thjesht je ndryshe. Tiparet e tua më duken të njohura, edhe pse nuk e di ku i kam parë.



Të gjitha pjesët e nënvizuara janë folje.

Folja tregon veprim a gjendje të njerëzve, kafshëve etj.



Ushtrohem



1. Krijë një tekst të shkurtër me një nga pamjet e dhëna. Nënvizë foljet.
2. Dalo foljet në vargun e fjalëve: *nënë, shtëpi, shkoj, flutur, fluturoj, diell, mbledh, shkëlqen, kisha, muri, gëzova, këndoj, deti.*
Shpjego zgjedhjen tënde.

Njohuri gjuhësore



Kohët e foljes. Koha e tashme, e shkuar, e ardhme

Unë jam Elio.
Unë kam flokë gështenjë.



Ti ke një qen.
Si quhet qeni yt?



Qeni im quhet Piku.
Po qeni yt si quhet?

Kjo është gjyshja ime.
Ajo quhet Liza.



Ne jemi shokë të mirë.
Ne kemi shumë libra.



Ju jeni shokët tanë.
Ju keni shtëpi të bukur.
Ata/ato janë pjesë e korit të shkollës.
Ata/ato kanë shumë libra në duar.

Foljet në kohën e tashme tregojnë një veprim që po ndodh në çastin që flasim.

unë **kam** ne **kemi**
ti **ke** ju **keni**
ajo/ai **ka** ata/ato **kanë**

unë **jam** ne **jemi**
ti **je** ju **jeni**
ajo/ai **është** ata/ato **janë**

1. Plotëso fjalitë me foljen që duhet.

Unë _____ Besniku.

Ti _____ Mira.

Ai _____ i shkathët.

Ajo _____ e dashur.

Ne _____ nxënës.

Ju _____ prindër.

Ata _____ alpinistë.

Ato _____ shoqe.



2. Shkruaj saktë foljet në tekstin e mëposhtëm.

Unë ka vëlla. Ai je në klasën e tretë. Ai jam më i gjatë se unë.

Unë e dua shumë atë. Edhe ai je i dashur me mua. Ne jam si shokë.



Njohuri gjuhësore

► Folja në kohën e tashme, të shkuar, të ardhme

Ishim



Jemi



Do të jemi



Dje ishte 6 mars.

Sot është 7 mars.

Nesër do të jetë 8 mars.

Dje përgatita dy dhurata. Sot është festa e Mësuesit. Nesër është Festa e Nënës.

Koha e shkuar

Koha e tashme

Koha e ardhme

Folja në kohën e shkuar tregon një veprim që është kryer më parë.

Folja në kohën e tashme tregon një veprim që kryhet tani.

Folja në kohën e ardhme tregon një veprim që do të kryhet më vonë.

1. Përgjigju me shkrim pyetjeve.

- Cila është stina e parë e vitit?
- Cila stinë është tani?
- Cila stinë vjen më pas?
- Çfarë do të bësh ti në dimër?
- Çfarë bëre në verë?
- Cila stinë do të vijë pas verës?



2. Lidh foljet me kohën përkatëse.

E ardhme	Erdhën gjyshërit për vizitë. Ata më sollën shumë dhurata.
E tashme	Isha duke fjetur në krevat. Shihja ëndrra të bukura.
E shkuar	Nesër do të jetë një ditë me diell. Unë e motra do të shkojmë në det.

3. Me foljet e dhëna, formo fjali në të tria kohët që mësove: *këndoj, fle, mbyll.*



Njoh heronjtë



Bariu i vogël dhe Skënderbeu

(Rrëfenjë)



Kruja kishte ditë që ishte rrethuar. Skënderbeu po vështronte nga mali.

Në këtë kohë rojat i sollën një djalë të vogël.

- E gjetëm këtu afër, po vinte te ne, - i tha një nga rojat.

Skënderbeu e pa me vëmendje. Djali mund të ishte dymbëdhjetë vjeç.

- Si mundë të vish gjer këtu? - e pyeti Skënderbeu.

- Turqit na dogjën fshatin dhe na morën gjithë bagëtinë, - tha djali.

Skënderbeu i përkëdheli flokët.

- Si të quajnë? - i tha.

- Tanush, - iu përgjigj djali.

- Mirë, Tanush i vogël, tani shko të çlodhesh.

- Po unë dua të luftoj kundër turqve! - tha Tanushi.

- Çlodhu se edhe ti do të kesh rast të luftosh, - i tha Skënderbeu. Tanushi përshendeti dhe u largua i gëzuar.





1. Ritrego bukur pjesën, duke u mbështetur tek fjalët kyçe: *Kruja e rrethuar, Skënderbeu, Tanushi, armik.*

2. Përshkruaj Tanushin sipas përfytyrimit tënd.

3. Skënderbeu në këtë pjesë shfaqet:

- a - i rreptë,
- b - bujar,
- c - i ashpër.

4. Tanushi në këtë pjesë shfaqet:

- a - frikacak,
- b - trim,
- c - guximtar.

5. Si vazhdon pjesa sipas teje?



Njohuri gjuhësore



Fjala dëftore dhe përdorimi i pikës

(Drejtshkrim)

Fjalët lidhen me njëra-tjetrën sipas një kuptimi logjik dhe formojnë fjali.
Fjala është bashkim logjik i disa fjalëve.
Fjala fillon me shkronjë të madhe dhe përfundon me shenjë pikësimi.



Diskutoj

1. Cila nga fjalitë e mëposhtme ka kuptim? Pse?

Shkolla është e dobishme për njeriun.

Është e dobishme, për shkolla njeriun.



Ushtrohem

1. Rendit sipas radhës së duhur grupet e fjalëve që të formojnë fjali.
Vendosu numra thasëve.



2. Lidh grupet e fjalëve që të formojnë fjali.

Lulet çelin	në dimër.
Dëbora bie	klasën e parë?
Bie shumë	në pranverë.
Shkon në	shi jashtë?

3. Vendosi fjalët në rendin e duhur për të krijuar fjali. Shkruaji në fletore.

Pas mësimit të luajmë shkuam me shokët futboll.

U pëlqen në det të lahen fëmijëve.

Ana nga çanta librat nxori.

4. Shëno me vijë fjalitë që kanë kuptim.

Djali ngriti lart flamurin.

Në çanta lapsa, libra kishte.

Në shtëpi më iku djali me nënën.

Flora luan në piano.

► Diktim

Në një kodrinë pranë pyllit, jetonte një fis i madh milingonash. Ato ishin punëtore dhe shkonin shumë mirë me kafshët dhe shpendët që banonin rreth e rrotull. Një ditë prej ditësh një derr i egër i zi doli nga pylli, ndali mbi kodrinë, u shtri dhe filloi të ngrohej në diell. Ai nuk sillej mirë me të tjerët. Nuk kisht shok asnjë nga banorët e pyllit. Ndërkohë milingonat e palodhura shkonin e vinin nga foleja, sepse po mblidhnin ushqim për në dimër.

- Dëgjoni moj milingona, - thirri derri me inat. - Unë po fle dhe nuk dua asnjë zhurmë.



Ushtrhem

Shkruaj saktë tekstin e mësipërm. Përdor si duhet shkronjën e madhe.

Mbaj mend

Në fund të fjalisë dëftore vihet pikë.

Mbas pikës fillohet gjithmonë me shkronjë të madhe.

Njohuri gjuhësore

► Fjalja dëftore dhe përdorimi i pikës

Lexoni tekstin e mëposhtëm.

Ky është atdheu im. Ai quhet Shqipëri. Ky është flamuri ynë që na bën krenar. Shqiponja dykrenare është një ndër simbolet tona kombëtare.

Fjalitë e mësipërme na tregojnë një gjë që e dimë me saktësi. Fjalitë me të cilat rrëfejme për diçka quhen **fjali dëftore**. Në fund të fjalisë dëftore vendoset gjithmonë pikë. Pas pikës, fjalitë fillojnë gjithmonë me shkronjë të madhe.

Fillimi
Shkronjë e madhe



Fundi
Pika



Ushtrhem

1. Në fjalitë e mëposhtme vendos aty ku duhet pikën, si dhe shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.

Era kishte rrëzuar gjithandej gjethet e thara ato i shihje gjithkund të gjithë fëmijët vendosën të dalin dhe të pastrojnë kopshtin askush prej tyre nuk ndenji në shtëpi.

2. Shkruaj nga një fjali për secilën figurë.



3. Nënvizo shkronjën e madhe dhe pikën.

Mamaja ime është mjeke. Ajo quhet Jeta. Ajo kujdeset për fëmijët e sëmurë. Kur të rritem dua t'i ngjaj asaj.

4. Përshkruaj veten duke përdorur fjalitë dëftore.

Dheu është flori

(Prëfënjë)

Hyrja

Një bujk plak para se të vdiste, thirri tre bijtë e tij pranë dhe u tha:

Zhvillimi

- O bijtë e mi! Me arën që e kam punuar gjithë jetën time, dhe me drithin e saj ju kam ushqyer e ju kam rritur. Në atë arë kam fshehur një shtambë me florinj. Mihni thellë dhe kërkoni te të gjitha anët e arës ta gjeni atë shtambë, që pastaj të mos vuani nga varfëria.

Të tre bijtë e plakut, pas vdekjes së t'et zunë të mihnin arën në të gjitha anët, thellë e më thellë. Mot për mot e thellonin nga një pëllëmbë më tepër. Po shtambën nuk e gjetën. Ara, duke u punuar më thellë, zu të japë më tepër. Të tre vëllezërit, jo vetëm nxirrnin bukën e shtëpisë, por dhe u tepronte shumë për të shitur. Të hollat që merrnin nga këto të shitura i hidhnin në një shtambë për t'i ruajtur. Në pesë vjet shtamba u mbush me florinj...

Mbyllja

Atëherë vëllezërit e morën vesh ku ishte shtamba me florinj, që u tha i ati.

(Sami Frashëri)



Lexoj

► **Përralla përbëhet nga tri pjesë:
hyrja, zhvilimi, mbyllja.**

1. Cilat janë personazhet në këtë përrallë?
2. Çfarë u tha plaku bijve?
3. Cili ishte qëllimi i plakut?
4. A e kuptuan djemtë këtë qëllim?
5. A jep kjo përrallë ndonjë mesazh për ju?
6. Përshkruaje përmbajtjen e përrallës me dy-tri fjali.

Fjalor

drithë – gruri, misri etj.


shtambë – enë balte.

mih – punoj tokën me shat, me bel.

mot për mot – vit pas viti.

të holla – para.





Fjalë të mençura të popullit

1. Do të rrosh me nder mbi dhe, me të ligj mos u përzie.
2. Gjaku s'plaket kurrë.
3. Më mirë të të shkasë këmba, sesa fjala.
4. Gjuha, kur zgjatet, është vështirë të matet.
5. Fëmija që përkëdhelet, prapa shokëve ngelet.
6. Për të thënë "di" është gjë e lehtë, për ta ditur se sa di është e vështirë.



DETYRË

Fjalët e urta na mësojnë mbi respektin, besën, nderin, maturinë, zgjuarësinë.

1. Gjeji këto cilësi në fjalët e urta të dhëna më lart.
2. Zgjidh njëren nga fjalët e urta dhe trego si e kupton ti atë.
3. Gjej me ndihmën e prindërve disa fjalë të urta dhe shkruaji në fletore.

Njohuri gjuhësore



Fjalia pyetëse dhe përdorimi i pikëpyetjes

(Drejtshkrim)

Si je? → Mirë, faleminderit!
Sa vjeç je? → Unë jam 7 vjeç.
Si quhet mësuesja jote? → Mësuesja ime quhet Arta.

- Vëre shenjën e pikësimit në fjalitë me të cilat pyesim dhe shenjën e pikësimit në fjalitë me të cilat përgjigjemi. Si ndryshon ajo?

Fjalitë me të cilat pyesim për gjërat që ne s'i dimë, quhen **fjali pyetëse**.
Ato mbarojnë gjithmonë me pikëpyetje.

Çfarë? Ku? Cili? Sa?

Këto janë disa nga fjalët që na shërbejnë për të pyetur.



**Ku jeton ti?
Cili është atdheu yt?**

Linja 3

Njohuri për kulturën dhe gjuhën shqipe



1. Shiko figurën dhe drejto pyetje rreth saj.

2. Ktheji fjalitë e mëposhtme në fjali pyetëse.

Atdheu im është Shqipëria.

A është Shqipëria atdheu im?

Unë jam në klasën e dytë.

-----?

Ora është 10 fiks.

-----?

Ky është vëllai im.

-----?

3. Krijoni tri fjali pyetëse për fjalinë e mëposhtme.

Nënë Tereza është simboli i Paqes.

Kush _____?


Cilat _____?

Çfarë _____?

4. Shkruaj një bisedë me shokun apo shoqen.

Drejto pyetje dhe merr përgjigje.

Lexoj



Kësulkuqja

(Përrallë)

Një ditë



mori



me



dhe u nis për tek



. Rruga kalonte nëpër



. Ajo hyri në



dhe nisi

të mblidhte



. Papritur para i doli



- Ku po shkon moj



?

- Tek



- Po ku banon



jote?

- Matanë



, - tha kësulkuqja.



iku me vrap, kurse



vazhdoi të mblidhte lule.

Më në fund Kësulëkuqja arriti tek  . Tak-tak-tak.



- hape derën! Nga brenda u dëgjua një zë i trashë.



-Hapur e ke.  hyri brenda dhe iu afrua . E habitur e pyeti:



- pse i ke  kaq të mëdhenj?

- Për të të parë më mirë bija ime. - Po  përse i ke kaq të mëdhenj?

- Për të të dëgjuar më mirë bija ime. - Po gojën pse e ke kaq të madhe?

- Për të të ngrënë ty, moj  .  deshi ta hante  , por

rojtari e pa nga dritarja dhe e vrau ujkun.  i tha:


- Faleminderit, më shpëtove jetën. Ajo u kthye e lumtur në shtëpi.



DETYRË

1. Luani në role përrallën.
2. Shiko me kujdes shenjat e pikësimit që janë përdorur.
3. Sill edhe ti një përrallë në klasë.

Njoh bukuritë e vendit tim



Thethi



A e njihni Sidritën? Sigurisht që jo. Ajo banon shumë larg jush, në Theth. Thethi është një fshat i bukur, i futur thellë mes malesh. Në Theth natyra është e bukur. Atje ka shumë pisha me gjethe si gjilpërë, që gjelbërojnë gjithë vitin.

Sidrita nuk ngopet me bukurinë e fshatit të saj. Ajo ka ftuar për vizitë në pushimet e verës, Kaltrinën me të cilën është njohur në Prishtinë, verën që shkoi. Ajo pret me padurim të vijë vera dhe të kalojë me Sidritën, disa ditë në Thethin e saj, pranë burimeve me ujë të ftohtë dhe të kthjellët.

1. Ku ndodhet Thethi?

Thethi ndodhet në:

- a) Shqipëri
- b) Itali
- c) Greqi



2. Përse është i bukur Thethi?

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

3. Cila është vendlindja e prindërve të tu?

4. Çfarë di ti për të?



DETYRË

Përshkruaj vendlindjen tënde, duke e ilustruar me foto.

Lexoj



Baba Viti dhe fëmijët e tij

Baba Viti ka katër fëmijë. Fëmija i parë quhet Pranvera, i dyti Vera, i treti Vjeshta dhe i katërti Dimri. Çdo fëmijë i tij e shijon jetën për tre muaj.

Pranvera lind në muajin mars dhe jeton edhe në prill e maj.

Vera jeton në muajt: qershor, korrik, gusht.

Vjeshta kurorëzohet në muajt: shtator, tetor, nëntor.

Dimri mbretëron në muajt: dhjetor, janar, shkurt.

Baba Viti është i lumtur për fëmijët e tij. Më 1 janar ai e nis jetën me djalin e tij Dimrin.

1. Shkruaj të gjithë muajt e vitit.

Janar, _____

2. Emërto stinët në figurat e mëposhtme.



Linja 3

Njohuri për kulturën dhe gjuhën shqipe

3. Sa muaj ka viti? _____



4. Shkruani ditët e javës.

E hënë, _____



DETYRË

Shkruani në fletore: ditët e javës, muajt dhe stinët.

Shkruaj



Shkruaj një letër



1. Plotëso fjalët në letër.

Vëlla Bledi,

E mo... let... tënde

plot me ur...

Kam shu... dësh... të ta...hemi

sa më parë.

Të ftoj për Fe... e Flam...

Të pres,

Flori

I dashur



2. Lexo letrën e Kaltrinės. A ka të drejtë ajo? Përgjigju ti letrës së saj.

E dashur Liridona,

Sot unë kam marrë një kotele të vogël. Emrin ia vura Toto. Kam gjithë ditën që rri me të. E dua shumë, por qeni im u bë keq. Ai nuk më afrohet.

Punë e madhe! S'më bëhet vonë.

Tani kam Totonë. Më shkruaj edhe ti për kotelen tënde.


Të fala,

Kaltrina.



DETYRË

Shkruaj edhe ti një letër.



Fjala pohore dhe mohore



Unë **kam** kordele.
Unë **kam** veshur fund.



Unë **nuk** kam kordele.
Unë **nuk** kam veshur fund.

Vëreji me kujdes fjalitë për secilën figurë. Ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra?

Mbaj mend: Pjesëzat nuk, s' dhe fjalët askush, asnjëri, askund janë fjale që përdoren në fjali mohore.

Fjala pohore kthehet në fjali mohore me pjesëzat nuk ose s'.



Ushtrohem

1. Kthe fjalitë pohore në fjali mohore.

Unë kam një vëlla. Unë s' _____

Unë mësoj në klasën e dytë. _____

Ai ka gjithmonë ftohtë. _____

Aeroplani fluturon gjithkund. _____


2. Kthe në fjali pohore fjalitë mohore.

Ata nuk shkuan në ekskursion. Kali s'është i lodhur. Jetmiri s'kishte mësuar mësimin. Anila nuk ka motër.

3. Në tekstin e mëposhtëm shëno me të kuqe fjalitë pohore dhe me blu ato mohore.

Alba shkoi në shtëpi. Ajo nuk e pa derën që ishte e hapur. Nuk hyri brenda dhe s'kërkoi kukullat e saj. Ajo shkoi vrap te gjyshja që ishte në kopsht.

Njohuri gjuhësore



Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit

(Drejtshkrim)

Shkolla është shumë e mirë. — **dëftore**
Shkolla qenka shumë e mirë! — **habitore**
Po sikur të jetë kjo shkolla? — **pyetëse**

Mbaj mend

Fjalja dëftore mbaron me pikë.

Fjalja pyetëse mbaron me pikëpyetje.

Fjalitë habitore mbarojnë me pikëçuditje.

1. A janë vendosur shenjat e pikësimit në vendin e duhur? Shkruaji fjalitë si duhet në fletore.

Shiu filloi? Mbi çatitë e shtëpive ka rënë dëborë.

Sa shumë. Sa bukur. Fëmijët gëzojnë për këtë natyrë të bukur.

Por, ato gëzojnë edhe sepse do të bëjnë ski, dhe plak me borë?

Sa bukur do të duket?

Një ujk pa dy desh që kullotnin në një livadh?

Mirë se vjen, more ujk.

Na e ndaj këtë livadh në mes?

- Po si t'jua ndaj?

2. Vendos shenjën e pikësimit sipas tipit të fjalisë.

Një ditë mamaja e pyeti Valbonën për shoqet e shokët

Si quhen ata Me kë je më shumë shoqe Ajo u përgjigj se me të gjithë kalonte shumë mirë, por më shumë rri me Almën.

Sa e mirë është ajo Sa e bukur dhe sa e dashur me shokët e shoqet



3. Ktheji në pyetëse fjalitë e mëposhtme.

Jeni mirë me shëndet. _____ A jeni _____

Shkove me tren në Durrës. _____

Mora notë shumë të mirë. _____

► DIKTIM

- Po lë pas tre mjekë të mëdhenj si veten. Të gjithë u panë sy më sy të habitur. Njëri prej mjekëve e pyeti të sëmurin: - Mësuesi ynë i nderuar, cilët janë këta tre mjekë më të mëdhenj se ju? Na thoni që t'i njohim edhe ne, t'i nderojmë dhe të mësojmë edhe ne prej tyre. I sëmuri buzëqeshi dhe tha:
– Dielli, uji dhe ajri.



Mbrohem nga sëmundjet



Njollat e Njomëzës

(Mbrohem nga sëmundjet)

Një mëngjes Njomëza u ngrit nga gjumi me temperaturë. Faqet e njoma i ishin mbushur me njolla të kuqe. Njomëza ishte me rubeolë. Gjithë ditën ndenji në shtrat. Në ëndërr shihte miq e shokë, të njohur e të panjohur.

- Sa njolla të bukura paske! - i tha Flutura.

- Sikur të më jepje nja njëzet prej tyre, do të isha flutura më e bukur e pranverës. Njomëza ia dha disa njolla asaj.

Kur u ngrit nga gjumi, shkoi me vrap te pasqyra. Sa u gëzua. Njomëza nuk kishte me asnjë njollë.



1. Çfarë kishte Njomëza?

2. Cilat janë shoqet e saj?

3. Kush e shëroi Njomëzën? a) Flutura. b) Mjeku. c) Kërpudha.

4. Emërto disa sëmundje të fëmijëve: rubeola, fruthi, ...

5. Po ju a jeni sëmurë ndonjëherë? Kush u kujdes për ju?

Shkruaj me pesë fjali një tekst me titull “Kur unë isha sëmurë”, duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme.


Kur?

Ku?

Kush?

Si?

Çfarë?



Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Njerëzit filluan të punojnë. Duke punuar, plotësuan mungesat e mëdha. Mbollën tokat. Përdorën mjete udhëtimi: makina, trena etj. Ata zbuluan edhe shumë gjëra të tjera të vlefshme: radion, telefonin, televizorin, internetin etj. Po prapë ka dhe shumë gjëra që duhen plotësuar dhe shumë punë për të bërë.

Fjalët në fund të rreshtave ndahen në disa mënyra, po gjithmonë sipas rrokjeve.

munge-sat ose mun-gesat, mbo-llën, telefo-ni ose te-lefoni.

1. Ndaj në rrokje fjalët e mëposhtme.

toka, lumenjtë, karrige, shtrat, këpuce, çizme, limoni, njerëzit, kumbulla, ariu, avioni, helikopteri, shkolla.

2. Si mund të ndahen në fund të rreshtit fjalët e dhëna?

pallati (palla-t,.....)

makina (ma-kina,.....)

balona (ba-lona,.....)

lopata (lo-pata,.....)


çekiçi (.....,

Shkruaj

Shkruaj një faqe ditari

► I dashur ditar

Sot është festë kombëtare. Të gjithë së bashku me flamurë në dorë ishim tek Monumenti i Lirisë. Atje kishte shumë njerëz. Pasi u bë ceremonia e rastit, uruam njëri-tjetrin dhe u larguam.



31 dhjetor

Sot është dita e fundit të vitit. Nesër unë do të jem 1 vit më e madhe. Vendosëm që bashkë me familjen të dalim në mesnatë dhe të hedhim fishekzjarrë. Bashkë me to do të lutemi për dëshirat tona. Sa mirë! Nesër do takohemi përsëri, i dashur ditar im.


Mbaj mend

Njerëzit mbajnë ditar për të shënuar ngjarjet më të rëndësishme të vitit dhe për të mos i harruar ato.

A mbani edhe ti ditar? Nëse po, çfarë shënon në të?

Ditari është personal. Miri ia lexoi ditarin vëllait të tij, Anit. A mendon se kjo është një gjë normale? Si do të vepronte ti po të ishe në vendin e Mirit?





Fjalët me grupet e bashkëtingëlloreve (mb, nd, ng)

mban
humbas
ndihmë
ngas

mbulesë
ndryshk
mund
vend

ngarkim
ngop
kungull
këngë

ndez
këndez
çmend

1. Plotëso fjalët e mëposhtme me grupet e bashkëtingëlloreve që mungojnë: mb, nd, ng.

Kë__a ku__ull __aron

Ka__anë __ul __yll

2. Plotëso fjalët me bashkëtingëlloret: mg, ng, mb.

Arbri u __rit në këmbë. Ana __eli __rapa në rresht.

__rapa pallatit makina po __arkonte tulla.

3. Rretho grupet e bashkëtingëlloreve: mb, nd, ng.

Në mbrëmje vajza kuptoi të vërtetën. Kënga ishte e kopjuar, por festivali do të bëhej patjetër. Atëherë ajo vendosi të konkurronte me këngën tjetër.

Njohuri gjuhësore

► Diktim

Gjergji i harroi të nëntë plagët e tij, u ngrit e doli të luftonte bajlozin e zi. Bajlozi ishte veshur me parzmore të rënda hekuri, kish vënë në kokë përkrenare çeliku, e kishte shpatë të gjatë. Edhe kalin e kish ngarkuar me pllaka hekuri. Tundej dheu ku shkelte.

Sapo e pa Gjergji thirri: - Bëhu gati, bajloz, se të ka ardhur dita e fundit! Këtu i thonë Gjergj Elez Alia!

I lëshuan kuajt vrap në fushën e luftës tym më tym.

Gjergji e hodhi topuzin e vet dhe e qëlloi bajlozin në ballë. Bajlozi vdiq menjëherë.


Pasi e vrau bajlozin e zi, trimi u kthye fitimtar në shtëpi.



MËSOJ POEZI



**I KËNDOJ ATDHEUT
DHE GJUHËS SHQIPE**



Djali dhe shqiponja

(Poezi)



- O shqiponjë
O zog krenar
Udhëtimin për ku e ke marrë?
Nga je nis' ti fluturim?
A mos vallë
Në vendin tim?
- Po djalosh
Në atdhe jam nis'
Në tokat e dashura të Shqipërisë
Se atje e lirë unë jam
Atje, unë vendin e kam
- Më prit dhe mua, o shqiponjë
Se dhe unë kam shumë mall
Brenda meje rreh një zemër
Që më thotë:
Je shqiptar

(I. Isaku)

Kujt i drejtohet poezia?

Për ku ishte nisur shqiponja?

- a) Në male.
- b) Në pyje.
- c) Në Shqipëri.

Pse djali do të shkonte në Shqipëri?

- a) Kishte mall.
- b) Ishte pjesë e tokës shqiptare.
- c) Zemra i rrihte për Shqipërinë.



Diskutoj

Poezia “Djali dhe shqiponja”:

- a) Është e shkruar në vargje.
- b) Ka strofa.
- c) Vargjet kanë rimë.
- d) Recitohet me dëshirë.
- e) Ndihet me shpirt.

Njohuri gjuhësore



Sa të dua o Shqipëri!

(Poezi)



Sa të dua, o Shqipëri

Sa të dua, o Shqipëri,
sa mall ndiej e sa dëshirë,
për ty gaz e dashuri
m'u në zemër më ka mbirë!
Se për mua, o Atdhe,
Je një lule aq e vyer,
Sa nuk gjendet përmbi dhe,
Shpirtin tim për të ushqyer.

ASDRENI

Diskutoj


1. A e do ti Shqipërinë?
2. A ndien mall për të?
3. A dëshiron të shkosh shpesh në Shqipëri?
4. Ndihehsh krenar që je shqiptar?
5. Ç'di ti për historinë e atdheut të prindërve të tu?



DETYRË

1. Pyet prindërit për historinë e lavdishme të shqiptarëve. Diskuto rreth saj.
2. Mësoji përmendsh vargjet.





Gjuha shqipe

(Poezi)

Duaje dhe ruaje gjuhën shqipe si sytë e ballit.

Gjuha jonë sa e mirë,
Sa e ëmbël sa e gjerë,
Sa e lehtë, sa e lirë,
Sa e bukur, sa e vlerë.



(Naim Frashëri)


Përmbyza që lëshon bylbyli,
Gjuha shqipe m' shungullon,
Përmbyza erë që jep zymbyli
Pa da zemrën ma ngushëllon.

Ndër kombe të tjera,
Ndër dhena të tjera,
Ku e shkoj jetën tash sa mot,
Veç për ty m' rreh zemra e mjera
E prej mallit derdhi lot.



(Ndre Mjeda)

Porsi vala e bregut të detit,
Por si gjama e rrfesë zhgjetare,
Porsi oshtima e një tërmeti,
Njashtu asht' gjuha jonë shqiptare.
Pra mallkue njaj bir shqiptari,
Që këtë gjuhë të perëndisë,
Trashëgim që ia len i pari,
Trashëgim s' ia le ai fëmis.



(Gjergj Fishta)

Flas



Diskutoj

1. A e do ti gjuhën shqipe?
2. Pse duhet ta mësosh atë?
3. A e tregon gjuha prejardhjen tënde?
4. Pse poeti thote se gjuha shqipe është: *e ëmbël, si vala e bregut të detit, si gjama e rrufesë, si kënga e bilbilit?*
5. Zgjidh një nga strofat e dhëna dhe mësoje përmendësh.



LUAJ DHE GJEJ



Lexoj



Komunikoj në largësi

Mira me Gentën flasin me



. Shpesh ato komunikojnë

edhe me



. Kur vjen vera dhe shkojnë me

pushime, ato i shkruajnë njëra-tjetrës



. Sa shumë gjëra thonë!

Në xhepin e çantës së tyre ato kanë gjithmonë celularin, shokun që i lidh në çdo çast me mesazhe të bukura.

Diskutoj

1. Nënvizoj fjalët që emërtojnë mjetet e komunikimit.
2. Cili të duket më interesant? Pse?
3. Cilin përdor më tepër? Pse?
 - a) Internetin.
 - b) Telefonin e shtëpisë.
 - c) Celularin.
 - d) Letrën.

Detyrë

**Pyet prindërit si kanë komunikuar ata dikur? Po gjyshërit?
Po në kohën e Skënderbeut, si komunikonin?**

Lexoj

► Kompjuteri

Tani me Tean blenë një kompjuter të ri. I pari punon me kompjuter Artani. Kur u ra tasteve katër + pesë =, pa në ekran nëntë.

Kur u ra tasteve tre + katër =, në ekran pa shtatën. Artani bërtiti:

- Ua, e bëra matematikën!

Kompjuteri i tha:

- E bëra unë. Tani puno ti.

Me kompjuter Tani dhe Tea mësojnë për: librat, motin, malet, pemët, lulet dhe tërë botën.



Rretho përgjigjen.

Artani në kompjuter:

a) shkruan, b) luan, c) lexon, d) mëson.

Kompjuteri të mëson për:

a) librat, b) motin, c) botën.



Diskutoj


1. Po ty, a të pëlqen kompjuteri?
2. Për çfarë e përdor atë?
3. Sa gjatë duhet të qëndrojmë në kompjuter?



DETYRË

Bëj një listë gjërash që mund të bëhen nëpërmjet kompjuterit.

Gjëegjëza



Kush e gjen?

Shtatë thupra
ngjyra-ngjyra
s'i ka shporta
por, natyra.

(Ylberi.)



Një pallat i madh vërtet
jo në tokë, por në det.

(Trageti.)



A e dini ç'është vallë
një insekt, insekt i rrallë
me një dritë si elektrik
herë e ndez e herë e fik?

(Xixëllonja.)



Dhëmbë s'ka
por, kocka bluan.

(Gjuha.)



Kur i lidh ikin
kur i zgjidh, rrinë.

(Këpucët.)



DETYRË

**Me ndihmën e prindërve, gjej disa
gjëegjëza dhe shkruaji në fletore.**

Gjëegjëza

Miri



Miri kishte **1** qen të  ur e besnik. **1** ditë, kur po bënte



-yrat,  - i u  - ua dhe filloi të lehte.

-Ç'pate? Mos  kon një  ?

- Po. Në fletoren tënde ndodhet **1**   gjatë.

Mua më quajnë  kurse ti në fletore  e ke shkruar çen.

-Miri hapi  -të...

HISTORI E SHQIPTARËVE

Stema e Republikës së Shqipërisë



Flamuri Kombëtar i Shqiptarëve

*Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshirë, e një qëllim,
Të gjithë, atij duke, ju betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!*

(Himni i Flamurit)

Pema e familjes

Njerëzit e parë jetonin në grupe.

Familja shqiptare ka ndryshuar me kalimin e kohës.
Dikur, në një banesë jetonin disa breza. Kjo quhej familje patriarkale. Një familje kishte rreth tridhjetë a më shumë anëtarë të një gjaku. Burrat kishin të drejta. Gratë nuk i kishin të drejtat e burrit.



Emërto.



Gjyshja



Historia e shqiptarëve




Diskutoj

1. Të parët e gjakut tim

- a. Stërgjyshi im quhet...
- b. Stërgjyshja...
- c. Gjyshi...
- d. Gjyshja...
- e. Halla...
- f. Xhaxhai...
- g. Babai...
- h. Nëna...

Kjo është një familje...



DETYRË

1. Sill në klasë kujtime nga jeta e gjyshërve a prindërve të tu.
2. Ndërto hartën e prejardhjes së familjes tënde.

Sot ne jetojmë në familje me 4 deri në 6 anëtarë. Të gjithë janë të rëndësishëm. Nëna dhe babai punojnë si brenda familjes, ashtu edhe jashtë saj.

2. Rretho po ose jo. Familja ime përbëhet nga:

- | | | |
|---------------------|----|----|
| 1. Gjyshi - gjyshja | Po | Jo |
| 2. Motra - vëllai | Po | Jo |
| 3. Babai - mamaja | Po | Jo |



DISKUTOJ

1. Si jetoni në familjen tënde?
2. Po në familjen e shokut tënd?
3. Si jetojnë të afërmit tuaj në Shqipëri, Kosovë a kudo ku jetojnë shqiptarë?

2. Festa kombëtare

Në familje ne festojmë festa të ndryshme, familjare dhe kombëtare. Festat kombëtare janë ato festa, të cilat përkujtojnë ngjarje të rëndësishme të kombit shqiptar. Festat më të rëndësishme kombëtare janë:

► Dita e Pavarësisë



Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, Vlorë, 1912



PORTRET: SHPALLJA E PAVARËSISË - VLORË I
ISA BOLETINI puth flamurin

Kjo ditë quhet edhe Dita e Flamurit. Më 28 Nëntor 1912 Ismail Qemali, ngriti në Vlorë, flamurin kuq e zi. Shqipëria fitoi pavarësinë prej pushtuesve osmanë. Ajo u shpall shtet i pavarur. Kjo ditë festohet në Shqipëri dhe në çdo vend të botës ku jetojnë bijtë e saj, shqiptarët.



Diskutoj

- Cilat quhen festa kombëtare?
- Ç'të kujton data 28 Nëntor 1912?
- Kush e ngriti flamurin kombëtar?
- Pse e festojnë shqiptarët këtë ditë?
- A festohet në familjen tënde Dita e Pavarësisë?



Shqiptarët e Amerikës festojnë
Ditën e Pavarësisë, 2007



DETYRË

Vizato flamurin kombëtar.

Historia e shqiptarëve

► Dita e Çlirimit të Shqipërisë

Atdheu ynë, Shqipëria, u pushtua, më 7 prill 1939 nga Italia fashiste. Në shtator të vitit 1943 kjo ushtri u largua dhe në Shqipëri erdhën gjermanët. Shqipëtarët luftuan më zemër për ta çliruar atdheun nga pushtuesit. Shumë luftëtarë dhanë jetën për lirinë e atdheut. Pas shumë sakrificash, Shqipëria u çlirua, më 29 Nëntor 1944. Kjo është një ngjarje kombëtare shumë e rëndësishme prandaj shqipëtarët e festojnë atë.



Monumenti i rezistencës së shqiptarëve kundër fashistëve italianë



Monumenti "Nëna Shqipëri", Tiranë



Diskutoj

- Kur u pushtua Shqipëria nga Italia fashiste?
- Cilat qenë përpjekjet e shqiptarëve për t'u çliruar nga fashistët italianë dhe nazistët gjermanë?
- Pse e festojnë shqipëtarët datën 29 nëntor?



DETYRË

1. Vizato një luftëtar të luftës çlirimtare të shqiptarëve, sipas përfytyrimit tënd.
2. Përshkruaj si festohet në familjen tënde Dita e Çlirimit.

Linja 1

Identiteti shqiptar

Shqiptarët

Banorët e Shqipërisë quhen shqiptarë. Ata flasin gjuhën e bukur shqipe.

► Shqiptarëve u pëlqen:

Të punojnë



Të lexojnë



Të këndojnë



Të kërcëjnë



Të njohin botën

Të jetojnë si të tjerët



Historia e shqiptarëve

Natyra



Deti



Arti



Jeta familjare



Mbaj mend

*Shqipëria është atdheu i prindërve të tu, pra është dhe atdheu yt. Gjuha shqipe është gjuha më e bukur. Ajo është pjesë e identitetit tënd. **Mësoje!***



DETYRË

Puno në grup.

Grupi I – Pyet prindërit për të parët e tu, ilirët, dhe sill në klasë informacion.

Grupi II – Pyet prindërit për natyrën dhe jetën në Shqipëri dhe sill në klasë informacion.

Vendlindja e të parëve tanë

Të parët tanë ishin ilirët. Ata janë stërgjyshërit tanë. Vendi ku banonin quhej **Iliri**. Ilirët jetonin në fise. Fiset kryesore ishin:

- **Taulantët.** Në tokat e tyre, sot, shtrihen qytetet e Fierit, Lushnjës, Durrësit etj.



Apolloni (Fieri)



Ardenica (Lushnjë)



Amfiteatri i Durrësit

- **Dalmatët dhe Ardianët.** Në tokat e tyre, sot, shtrihet pjesa perëndimore e Kroacisë, Bosnje - Hercegovinës.



Harta e shteteve të Ballkanit



Autore,
Fatmiroshe
Xhemalaj

Historia e shqiptarëve

- **Enkelejtë.** Në tokat e tyre, sot, shtrihet Pogradeci, Korça, Erseka, Devolli etj.



Varret monumentale të Selcës (Pogradec) gjetur në territorin e Enkelejve së bashku me stolitë



Stoli, të gjetura në varrin monumental të Selcës



Qyteti antik i Ulpianës (afër Prishtinës)



Mozaiku i Kishës së Linës, Pogradec

- **Dardanët.** Në tokat e tyre, sot, shtrihet Kosova.



Prishtina, kryeqyteti i Kosovës



DETYRË

1. Cilët janë të parët e tu?
2. Cila është vendlindja e të parëve të tu?
Po vendlindja jote?
3. Sill në klasë fotografi të vendlindjes tënde.



Tiranë



Prishtinë

► Mbaj mend

Të parët tanë, ilirët ndërtuan qytete, zhvilluan bujqësinë, lundrimin, punuan metalet, krijuan mbretëri etj.



Mbretëresha ilire "Teuta"

Historia e shqiptarëve

Ilirët u morën me:

Bujqësi



Lundrim



Ndërtim



Punim metalesh



Blegtori



Shqipëria dhe Kosova

► Unë sot jetoj në: _____.

Unë shkoj në shkollën _____.

Shoku/shoqja ime e zemrës është _____.

Mësues/ja im/e quhet _____.

Në shkollën time ne bëjmë udhëtime. Po. Jo.

Në shkollën time ne bëjmë shëtitje. Po. Jo.

Në shkollën time ne bëjmë koncerte. Po. Jo.



► Vazhdoje listën e veprimtarive të shkollës tënde.

A ndihesh ti pjesë e këtij vendi? Po. Jo. Pse? _____

A dallohesh ti nga nxënësit e tjerë? Po. Jo. Pse? _____

► Ku dallon ti nga shokët e shoqet e vendit ku jeton?

1. Gjuha. Po. Jo.

2. Zakonet. Po. Jo.

3. Familja. Po. Jo.

4. Festat. Po. Jo.

5. Simbolet kombëtare. Po. Jo.

6. Veshja. Po. Jo.

► Vazhdoje listën e dallimeve me të tjerët. Çfarë të përbashkëtash ke me shokët e shoqet e vendit ku jeton?

1. Lagjen. Po. Jo.


2. Shkollën. Po. Jo.

3. Mësuesit. Po. Jo.

4. Vendet publike. Po. Jo.

► Vazhdoje listën e të përbashkëtave me të tjerët.

GJEOGRAFI: TROJE KU BANOJNË SHQIPTARË NDËR SHEKUJ



Shqipëria dhe Kosova


1. Vendi i prejardhjes së të parëve të mi



DISKUTOJ

1. Thuaj çfarë di për Shqipërinë dhe Kosovën.

2. A ke vizituar ndonjë vend atje?



DETYRË


Përshkruaj qytetin ose fshatin tënd.

Gjeografi: Troje ku banojnë shqiptarë ndër shekuj

2. Ky është atdheu im




Tirana



Berati




Vlora



Korça



Mali i Korabit






Shkodra

Liqenet dhe Pyjet e Lurës



Linja 1

Identiteti shqiptar



Gjeografi: Troje ku banojnë shqiptarë ndër shekuj

3. Republika e Shqipërisë

Republika e Shqipërisë shtrihet në Gadishullin e Ballkanit në Evropën Juglindore. Ajo laget nga dy dete: deti Adriatik e deti Jon.

Pika më veriore e Republikës së Shqipërisë është Vermoshi. Pika më jugore është Konispoli.

Sipërfaqja e Republikës së Shqipërisë është 28 748 km².

Ajo kufizohet me: Republikën e Kosovës në verilindje, Maqedoninë e Veriut në lindje, Republikën e Greqisë në jug e juglindje, Republikën Malit të Zi në veriperëndim.

► Shqipëria ka:

a) Male: Mali i Korabit, Mal i Gramozit, Mali i Dajtit, Mali i Tomorrit...

Vazhdoje ti më tej: _____

b) Fusha: Fusha e Myzeqesë, Fusha e Shkodrës...

Vazhdoje ti më tej: _____

c) Lugina: Lugina e Drinit, Lugina e Matit...

d) Dete: 1 _____ 2 _____



Hartë, Republika e Shqipërisë

4. Republika e Kosovës

Kosova gjendet në qendër të pjesës perëndimore të Ballkanit. Ajo kufizohet nga:



Kosovë

Sipërfaqja e Kosovës është 10 887 km.

► **Kosova ka:**

a) **Male:** Bjeshkët e Namuna, Mali i Hasit, Mali i Sharrit...

Vazhdoje ti më tej: _____

b) **Fusha:** Fusha e Drenicës, Fusha e Llapit, Fusha e Anamoravës...

Vazhdoje ti më tej: _____

c) **Gryka:** Gryka e Prushit, Gryka e Kaçanikut, Gryka e Rugovës...

Vazhdoje ti më tej: _____



Republika e Serbisë



Republika e Shqipërisë



Republika e Malit të Zi



Republika e Maqedonisë së Veriut


Gjeografi: Troje ku banojnë shqiptarë ndër shekuj

Diskutoj

1. Cilat vende shqiptare ke vizituar?
Çfarë të ka lënë mbresë?

2. Shkruaj emra malesh, fushash, detesh, luginash, grykash që shtrihen në tokat shqiptare.

3. Përshkruaj qytetin/fshatin ku ke lindur ti/prindërit e tu.



Prindërit e mi janë nga:



Ata janë nga qyteti/ fshati: _____

Prindërit e Gentit janë nga

qyteti i Prishtinës.



Veçoritë natyrore të viseve shqiptare

1. Relievi dhe klima e viseve shqiptare

Në viset shqiptare ka më tepër kodra e male, por nuk mungojnë fushat, luginat dhe lugjet. Klima e Shqipërisë është e shumëllojshme. Ajo është e ndryshme në bregdet, fusha e male. Në verë, klima është e freskët në bregdet dhe male, kurse në dimër, bie borë në male dhe shumë shi në fusha.

Viset shqiptare kanë dalje në detin Mesdhe. Aty kalojnë rrugë të rëndësishme që i lidhin ato me Italinë e vendet e tjera të Evropës, me vendet e Ballkanit, Turqinë e më tej. Po kështu, përmes këtyre rrugëve vendet e lindjes lidhen me vendet e perëndimit dhe e kundërta. Që në lashtësi viset shqiptare janë lidhur me botën me rrugë të rëndësishme, si: Rruga Egnatia, e cila përmes Ilirisë lidhte Romën me Kostandinopojën.



Roma e vjetër



Rruga Egnatia



Kostandinopojja

Gjeografi: Troje ku banojnë shqiptarë ndër shekuj

2. Ujërat që lagin viset shqiptare

Në përfundim, viset shqiptare lagen nga deti Adriatik dhe deti Jon.



Durrësi


► Plotëso.

Në brigjet e deteve Adriatik dhe Jon ka disa plazhe, të tilla janë: Durrësi, _____

Viset shqiptare përshkohen nga shumë lumenj si: Drini, mbi të cilin janë ndërtuar disa hidrocentrale, Buna, Mati, Shkumbini, Semani, Vjosa etj.

► Detyrë.

Rendit disa lumenj të tjerë të viseve shqiptare.



Lumi, Drini i Bardhë

3. Bimësia

Në Shqipëri rriten rreth 30 lloje bimësh. Disa prej tyre janë:

Dushku



Lulëkuqja



Fieri



Portokalli



Ulliri



Pisha e zezë



Rrushi



Bredhi i Drenovës



Gështenja



DETYRË

Pyet prindërit për llojet e bimëve që rriten në vendlindjen e tyre. Diskuto së bashku me nxënësit e tjerë në klasë.

Gjeografi: Troje ku banojnë shqiptarë ndër shekuj

4. Kafshët dhe shpendët

Në viset shqiptare jetojnë lloje të shumta kafshësh e shpendësh.

Urithi		Lakuriqi i natës	
Ujku		Dhelpra	
Peshku, koran (rritet në liqenin e Pogradecit)		Ariu i murrmë	
Breshka		Macja e egër	
Kaprolli (sorkadhja)		Dhia e egër	
Derri i egër		Lepuri	
Shqiponja		Bilbili	



Puno në grup.

Bëj një listë me emra:

- a) kafshësh _____
- b) shpendësh _____
- c) peshqish _____

5. Bukuritë e Shqipërisë

Shqipëria ka shumë vende të bukura për t'u vizituar:



Liqenet e Lurës



Mali i Korabit



Bjeshkët e Namuna



Liqeni i Ohrit



Mali i Jezercës



Llogaraja

Gjeografi: Troje ku banojnë shqiptarë ndër shekuj

Në tokat shqiptare ka një trashëgimi të pasur të kulturës sonë. Disa prej tyre mbrohen si trashëgimi botërore.

Liqeni i Ohrit




Parku Kombëtar i Butrintit



Gjirokastra



Berati



Pamje e brendshme e Manastirit të Deçanit, Kosovë, në kohën e pushtimit osman



Manastiri i Graçanicës, Kosovë

Mbaj mend

Ne jemi një popull i lashtë me kulturë të lashtë.



DETYRË

Me ndihmën e prindërve sill në klasë foto të qyteteve e vendeve të bukura shqiptare.



Prejardhje e ndryshme, jetë e përbashkët

1. Veçoritë e shqiptarëve

Ne shqiptarët kemi shumë veçori që na dallojnë nga popujt e tjerë.

- a - **Gjuha.** Ne flasim gjuhën shqipe.
- b - **Flamuri.** Flamuri ynë është kuq e zi.
- c - **Himni Kombëtar.** Himni ynë kombëtar është “Rreth flamurit të përbashkuar”.
- d - **Zakonet e traditat.** Ne dallohemi për besë, mikpritje etj.
- e - **Këngët e vallet.**
- g - **Veshjet e bukura** të krahinave shqiptare.



2. Ne bëjmë jetë të përbashkët

1. Fëmijët kanë prejardhje të ndryshme.



2. Të gjithë kanë të drejta të barabarta. Iliri, Anxhelo dhe Paolo shkojnë në shkollë. Ata mësojnë e luajnë së bashku. Të gjithë ndihmojnë njëri-tjetrin dhe ndihen mirë kur veprojnë në këtë mënyrë.

3. Ata janë qytetarë të Evropës dhe të botës së lirë.



Mbaj mend

Respekto veten dhe të tjerët. Duaje vendin tënd dhe vendin ku jeton.



3. Edhe ne jemi pjesë e botës

Prindërit tuaj punojnë bashkë me të tjerët.
Ata ndihmojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin.

Ne jetojmë në rrugën:

Emërto _____

Fëmijët shqiptarë dallohen në mësim, shoqëri,
veprimtari etj.

Të gjithë i respektojnë për cilësitë që kanë.



Ata janë pjesë e botës së lirë, sepse punojnë, mësojnë dhe respektojnë të tjerët në vendin ku jetojnë.



Diskutoj

1. A e ndjen veten të barabartë me shokun apo shoqen që nuk ka prejardhjen tënde? Pse?
2. Si ndihesh ti në vendin ku jeton?




DETYRË

Pyet prindërit e tuaj, si ndihen ata në vendet e tyre të punës. Diskuto së bashku me nxënësit e tjerë në klasë.

TRASHËGIMIA KULTURORE E SHQIPTARËVE





Flamuri, simboli ynë kombëtar

Flamuri është simbol i një kombi. Pavarësisht pushtimeve në kohët e shkuara, shqiptarët e kanë ruajtur atë brez pas brezi.

Flamuri ynë ka dy ngjyra: fushë të kuqe dhe shqiponjë dykrerëshe me ngjyrë të zezë. Ai është dhe mbetet vlerë e paçmuar, simbol i kombit tonë.

Flamuri ynë kombëtar duhet të ruhet nga çdo pjesëtar i kombit shqiptar, si një pasuri jo vetëm kombëtare, por edhe individuale.

Flamuri ynë kombëtar përgjatë historisë:



1912-1914



1926-1928



1934-1939



1945-1991



1992 deri tani



Diskutoj

1. Ç'është flamuri kombëtar për ty?
2. Sa ngjyra ka flamuri shqiptar?

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Lojërat popullore shqiptare

Lojërat popullore janë krijime popullore. Ato kanë simbolikën e tyre, argëtojnë njerëzit dhe kanë efekt sa edukues, aq edhe çlodhës.

Disa nga lojërat popullore shqiptare më karakteristike janë:

1. Kaladibrance,
2. Mundje krahu,
3. Tërheqje litari,
4. Hapa dollapa etj.



Abdurrahim Buza “Lojra Popullore”

Shpjegimi i lojës “Hapa-dollapa”

Në lojën “Hapa-dollapa”, një nga lojtarët mbyll sytë, të tjerët fshihen. Mbasi mbyll sytë në një vend të caktuar, ai fillon të thotë me zë të lartë këto fjalë:


- Hapa-dollapa, kush është fshehur mbrapa? Dil se të kapa! Se unë sytë i hapa! ... Lojtari vazhdon, duke numëruar deri në 10. Pastaj hap sytë dhe kërkon shokët e fshehur.

Mbasi gjen të parin, shkon atje ku ka mbyllur sytë dhe bën pasin (prek me dorë vendin). Mbasi i gjen të gjithë, radhën për të mbyllur sytë e ka ai që është gjendur i pari. Në qoftë se njëri nga të fshehurit shkon më përpara dhe bën pasin, atëherë personi që i kërkon duhet të mbyllë sytë përsëri.



Detyrë

Përshkruaj një lojë popullore shqiptare.



Rrënjët e mia dhe të familjes sime

Rrënjët e familjes sonë shqiptare lidhen me origjinën dhe ekzistencën e kombit. Shumë elemente të identitetit janë jo vetëm të lindura, por edhe të mësuara. Ngjashmëria e çdo individi është e trashëguar. Trashëgimia kulturore dhe shpirtërore janë pjesë e identitetit të çdo njeriu.

Për shembull:

Fëmija



mund të ngjajë nga

pamja me babanë,



mund të ecë si



mund të flasë si mamaja,
etj.



mund të buzëqeshë si daja



Rrënjët tona janë të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore, e cila lidhet me të mësuarit, sportin, artin, të kënduarit etj.



Diskutoj

Me cilët pjesëtarë të familjes ngjason më shumë?

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve




Veglat muzikore popullore shqiptare

Lahuta, fyelli, çiftelia dhe sharkia

Lahuta

Lahuta është një nga instrumentet më të lashta të veglave me hark të kontinentit evropian. Sipas të dhënave, fiset ilire shquheshin për punimin e veglave muzikore. Zakonisht, në kokë dhe në bishtin e lahutës gdhendeshin figura që njerëzit adhuronin. Tradita e gdhendjes së saj ka ndryshuar në kohë. Sot, lahuta punohet nga vetë rapsodët që e përdorin. Kjo vegël muzikore përdoret kryesisht: në zonat mbi lumin Drin, Malësi të Madhe, Hot, Grudë, Shkrel, Kelmend, Kastrat, Dukagjin, Nikaj, Malësinë e Gjakovës etj.



Fyelli

Fyelli është përdorur për gëzime të ndryshme; nga barinjtë për të ndjellë qentë e për të nisur delet në mal gjatë verës etj. Është vegël e dashur për blegtorët shqiptarë dhe e përhapur në të gjitha viset e atdheut. Fyelli ka ndërtim të thjeshtë: një tytë cilindrike me disa vrima për gishtërinjtë. Materiali mund të jetë: dru, tunxh, hekur, shtog etj.



Fyell i vitit 1948. Muzeu etnografik, Krujë



Çiftelia

Çiftelia është vegla më e thjeshtë e familjes kordofone. Ajo ndërtohet nga tri pjesë: kupa, kapaku dhe bishti. Mund të jetë e vogël, mesatare ose e madhe. Tipi më i përhapur i çiftelisë është ai me dy tela, por ka edhe me shumë tela. Bishti ndahet nga 11 deri në 13 pjesë të shkallëzuara. Çiftelia përdoret tradicionalisht në veri të Shqipërisë.



Sharkia


Sharkia ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studiuesve. Ajo paraqitet si një çifteli e madhe me dy tela ose si një tambur me katër a pesë tela. Kjo vegël muzikore përdoret kryesisht në Gjakovë, Pejë, Drenicë, Prishtinë, Prizren, Podrinë, Tropojë, Kukës, Dibër etj.



Diskutoj

**Cilat vegla popullore shqiptare njeh më mirë?
Flit për to.**

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Veglat muzikore popullore shqiptare

Qypi, këmborët, zilet dhe pipëzat

Qypi

Qypi është një vegël muzikore që përdoret vetëm nga burrat për të shoqëruar ritmikiisht këngët dhe vallet popullore. Lëkura e qypit goditet me gishtërinj dhe nxjerr tinguj të butë dhe të larmishëm. Përdoret kryesisht në Shqipërinë e Mesme dhe në Kosovë.



Këmborët dhe zilet

Këmborët dhe zilet paraqiten me një larmi formash që ndryshojnë nga njëri vis i Shqipërisë në tjetrin, si: Labëri, Myzeqe, Malësi e Madhe etj.

Populli ynë i ka përdorur tradicionalisht këmborët: në blegtori, dasma etj.



Variante zilësh



Në Shqipërinë Juglindore zilet përdreshin në dasma. Në këngë dasme devollite thuhet:

*Të shtunën me natë
na vare bajraknë
bajraku me lule,
nusja vjen fodulle,
bajraku me zile
nusja vjen kastile.*



Ky zakon i lashtë është ruajtur gjer në shekullin XX në Shqipëri, kurse tek arbëreshët e Italisë ruhet ende. Përveç rëndësisë praktike këmborët kanë edhe vlerë estetike. Ato janë muzika e përhershme e fshatrave tanë.

Pipëza

Pipëza është një vegël e përhapur anë e mbanë trojeve shqiptare, por me emra të ndryshëm, sipas krahinave. Pipëzat janë dy llojesh: njëshe dhe dyshe.



Valle devollite

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve




Veprimtaritë tradicionale kombëtare për fëmijë

Fëmijët janë e ardhmja e kombit, e gjuhës dhe e kulturës.

Ata janë pjesë e një sërë veprimtarive, përfshi këtu edhe ato tradicionale e kombëtare, si: Festivali i Këngës për Fëmijë, Festivali Tipologjik i Valles Popullore etj.





Festivalet e këngës për fëmijë

Në Republikën e Shqipërisë ekziston një traditë e trashëgimisë shpirtërore në organizimin e veprimtarive tradicionale kombëtare të këngëve për fëmijë.

Prej më shumë se gjysmë shekulli, Festivali i Këngës për Fëmijë organizohet tradicionalisht në qytetin e Shkodrës.



Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Mjedisi dhe peizazhi shqiptar

Shqipëria, atdheu ynë i dashur, ka një natyrë të bukur dhe mbresëlënëse.

Disa vende piktoreske të Shqipërisë:

Bjeshkët, bregdeti shqiptar, liqenet e Lurës, zonat juglindore, pyjet e Barmashit, liqeni i Pogradecit, Divjaka etj. Vendi ynë ka jo vetëm pamje natyrore mahnitëse, por edhe shumë mjedise dhe objekte kulturore, pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare.



Pamje nga Divjaka



Pamje nga liqenet e Lurës

Kalaja e Himarës

Qyteti i vjetër i Himarës dhe kalaja e tij janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore e historike të Shqipërisë. Aty dëshmohen gjurmë të njerëzve që para 3500 vjetësh.



Linja 1

Identiteti shqiptar

Kalaja e Palermos

Kalaja e Palermos është ndërtuar nga Ali Pashë Tepelena. Ajo u ngrit mbi gërmadhat e një manastiri që gjendej atje.



Qeparoi i vjetër


Qeparoi është një fshat i bukur turistik. Ai ka një pamje dhe arkitektonikë tradicionale.



Diskutoj

Përmend zona piktoreske të Shqipërisë.
Trego për vende interesante shqiptare që ke vizituar apo dëshiron të vizitosh.

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Veshjet popullore shqiptare

Veshjet popullore kanë një interes të veçantë në kulturën e kombit shqiptar. Në këto veshje gjejmë gjurmë të kulturës ballkanike, mesdhetare, të kulturës ilire dhe asaj bizantine orientale, por dhe të Evropës perëndimore. Sipas historianëve veshjet tona kanë origjinë të hershme. Disa prej tyre janë:

Linja është një lloj këmishe e gjatë.

Xhoka përdoret nga shqiptarët e veriut, si dhe në Kosovë dhe Mal të Zi.

Kapuçi përdoret pothuajse në të gjitha zonat e vendit, kryesisht në veri.



Linja 1

Identiteti shqiptar

Opingat (me xhufka dhe pa xhufka) janë traditë autoktone ballkanike dhe përdoren në veri dhe jug të Shqipërisë.




Guna përdorej kryesisht nga barinjtë.

Fustanella e gjatë është veshje e përdorur.

Dolloma (një lloj fustanelle e gjatë) përdorej në veri të Shqipërisë. Mbas vitit 1912, kur Shqipëria u shpall e pavarur, këto lloje fustanellash pothuajse nuk u përdorën më.

Të gjitha këto veshje janë pjesë e kulturës popullore të shqiptarëve të sotëm.




Lloje kostumesh popullore



Diskutoj

Cilat janë disa nga elementet e veshjeve popullore tradicionale shqiptare?

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Kostumet popullore shqiptare

Kostumet kombëtare shqiptare i përkasin një trashëgimie kulturore të hershme dhe kanë veçori dalluese nga kostumet kombëtare të popujve të vendeve të tjera. Ato janë vlera të çmuara jo vetëm për popullin tonë, por edhe për të huajt. Sot numërohen rreth 140 lloje kostumesh kombëtare, burrash e grash.



Lloje kostumesh kombëtare shqiptare



Kostumet popullore kombëtare përbëjnë jo vetëm një pasuri materiale, por edhe një vlerë estetike për kombin shqiptar. Pjesët përbërëse të veshjeve janë të larmishme, si: brezat, qeleshet, opingat me xhufka dhe pa xhufka, gjoksoret etj.

Këto kostume ndahen në: kostume popullore burrash dhe kostume popullore grash.

Secili lloj ka pesë tipe veshjesh. Burrat kanë veshje me: fustanellë, dolloma (një llojë fustanelle), poture, tirqe, breçka. Gratë kanë veshje me: xhokë (këmishë e gjatë), xhubletë, mbështjellëse, këmishë të gjatë me dy futa dhe me brekushe.



Diskutoj

Vizato kostumin tradicional shqiptar që të pëlqen më shumë.

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Motive tradicionale shqiptare

Populli shqiptar e do shumë të bukurën. Kjo dashuri vihet re edhe në objektet shtëpiake dhe ato të përdorimit të përditshëm, si p.sh.: në një krrabë prej druri, një cyl dyjare, tekstile të ndryshme të punuara prej leshi, qilima, sixhade, çanta të ndryshme, poçe prej balte, punime shtize etj.



Zbukurimet përdoren gjithashtu edhe në veshje, të tilla si: **jeleku**, **qylafi**, **fustanella**.

Ato kanë një traditë shumëshekullore. Në të gjitha këto objekte etnografike dhe veshje popullore, gjejmë forcën e brendshme të krijimtarisë së popullit shqiptar.



Në qoftë se i shohim si mozaikë të vizatuar, ne mund të zbulojmë lehtë mënyrën e tyre të kompozimit, përmes vijave të thjeshta dhe motiveve të pasura.


Materialet e përdorura për realizimin e tyre janë: leshi, lini, këpri, pambuku, mëndafshi etj. Motivet tradicionale dallohen për origjinalitetin e tyre dhe kanë një simbolikë të caktuar.



▶ Detyrë

Vizato një jelek me motive popullore shqiptare.

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Kostume karakteristike të folklorit shqiptar

Përveçse trashëgimisë shpirtërore, Shqipëria ka edhe një trashëgimi materiale të pasur, e cila lidhet me zbulimet arkeologjike, kostumografinë popullore etj.

Në mësimet e mëparshme kemi folur për disa lloje veshjesh popullore por, në këtë mësim, do të sqarojmë disa lloje kostumesh karakteristike të folklorit shqiptar. Në to përfshihen kostumet e grupit folklorik të Tiranës, të Gjirokastrës, të Tepelenës, të Korçës, të Dibrës, të Matit, të Fierit etj.



Kostumi folklorik i Tiranës



Kostumi folklorik i Tropojës




Kostumi folklorik i Gjirokastrës



Detyrë

Me ndihmën e prindërve, kërko e gjej në internet disa kostume të tjera popullore.



Shqipëria përmes trashëgimisë shpirtërore

Shqipëria ka një trashëgimi të pasur shpirtërore. Ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë kulturore e shpirtërore kombëtare shqiptare, iso-polifonia shqiptare është shpallur nga UNESCO trashëgimi shpirtërore e njerëzimit.

Kryeveprat e trashëgimisë kulturore shqiptare:

1. **Iso-polifonia popullore shqiptare** është shpallur “Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit” nga UNESCO, më 25 nëntor 2005.



Iso-polifonia labe



Grupi polifonik i Dukatit

2. **Eposi i Kreshnikëve** është një cikël këngësh legjendare, i shoqëruar me lahutë, me në qendër dy vëllezër Mujin dhe Halilin. Eposi i Kreshnikëve këndohet në Malësinë e Madhe, Dukagjin, Has, Kosovë etj.



Këngëtar me lahutë



Trashëgimia kulturore e shqiptarëve

3. **Dialektet gjuhësore**, ku bëjnë pjesë dialekti geg dhe ai tosk, si dhe folklori gojor i të dyja dialekteve.

4. **Muzika popullore homofonike** e Shqipërisë së Mesme (Tiranë, Elbasan, Kavajë, Durrës, Krujë etj.), përfshirë folklori vokal, instrumental dhe koreografik.

5. **Ahengu qytetar shkodran**, si pjesë e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare.

6. **Mjeshtëria e punimit të veglave muzikore popullore** si zeje tradicionale, është pjesë e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare dhe përfshin punimin e instrumenteve, si: gajdja, fyelli, cula dyjare, çiftelia, sharkia, lahuta, dajra, daulla etj.



dajre



daulle



gajde

7. **Vallja e vajzave dropullite** është trashëgimi shpirtërore e minoritetit etnik grek dhe pjesë e diversitetit kulturor në Shqipëri.



Valle dropullite

Diskutoj

Dëgjo një këngë të trashëgimisë kombëtare shqiptare dhe një të trashëgimisë kombëtare të vendit ku jeton. Diskuto në klasë.



Figura të shquara të historisë shqiptare

Gjergj Kastriot Skënderbeu

Gjergj Kastrioti, djali i Gjon Kastriotit u rrëmbye nga turqit osmanë që në moshë të vogël dhe u rrit në oborrin e Sulltanit (njeriu më i pushtetshëm i Perandorisë Osmane). Sulltani e përgatiti atë si komandant në shkollën ushtarake dhe i dha emrin Iskënder (Aleksandër). Megjithatë, ai e ruajti në zemër dashurinë për vendlindjen e tij, Shqipërinë dhe natë e ditë mendonte se si të kthehej atje. Në vitin 1478, kur sulltani e dërgoi në një betejë afër Nishit, ai gjeti rastin për t'u kthyer në atdhe bashkë me 300 kalorësit e tij besnikë shqiptarë. Atje u prit si çlirimtar.

“Lirinë nuk jua solla unë, atë e gjeta mes jush”, u tha ai shqiptarëve.

Gjergj Kastrioti punoi për të bashkuar shqiptarët në luftë kundër turqve osmanë, për të ruajtur traditat dhe kulturën arbërore, si dhe për të krijuar shtetin shqiptar. Për forcimin e shtetit ai përdori martesat me familje të mëdha shqiptare e të huaja. Skënderbeu u martua me Donikën, vajzën e Gjergj Aranitit, princ shqiptar. Gjergj Kastriot Skënderbeu ishte një ushtarak dhe diplomat i zoti, hero kombëtar dhe mbetet një nga figurat legjendare e më të nderuara të kombit shqiptar.



Trashëgimia kulturore e shqiptarëve

Nënë Tereza

Nënë Tereza është një nga figurat më të dëgjuara, më të dashura dhe më të respektuara në të gjithë botën. Lindi, më 26 gusht 1910 në Shkup, në një familje shqiptarësh, të ardhur nga Mirdita. Emri i saj i plotë është Anjezë Bojaxhiu, por me përkëdheli i thërrisnin Gonxhe.

Mësimet fillore i ndoqi në një shkollë jokatolike. Mbasi ngeli jetime nga babai, nën përkujdesjen e së ëmës, Dranes që ishte katolike nga rrethinat e Gjakovës, Nënë Tereza frekuentoi rregullisht kishën e qytetit, derisa në moshën 18-vjeçare i lindi dëshira për t'u bërë "motër e shenjtë".

Studimet fetare i vijoi në Britaninë e Madhe dhe aty mori emrin e ri Nënë Tereza. Pa mbarimit të studimeve u nis me mision për në Kalkutë të Indisë, ku u bë drejtoreshë shkolle. Atje, në vitin 1948, me lejen e Papës së Romës, Nënë Tereza krijoi "Organizatën e Misionarëve të Bamirësisë", e cila u përhap me shpejtësi në të gjithë botën.

Vepra bamirëse e Nënë Terezës është e madhe dhe e njohur në të gjithë botën. Ajo punoi për njerëzit në nevojë. Për të njeriu ishte dhurata më e çmuar. Njerëz fetarë, politikanë, njerëz të artit dhe e gjithë bota e nderojnë veprën e saj. Ajo u shpall shenjtore e gjallë e pavdekshme.

Disa thënie të Nënë Terezës


Ç'është jeta?

- Mundësi, përfito nga ajo.
- Bukuri, adhuroje.
- Sfidë, sfidoje.
- Ëndërr, realizoje.
- Detyrë, plotësoje.
- E shtrenjtë, ruaje.
- Dhimbje, përballoje
- Shumë e çmuar, mos e shkatërro.
- Dashuri, shijoje.
- Mister, zbuloje.
- Pasuri, ruaje.
- Këngë, këndoje.
- Luftë, pranoje.
- Lojë, luaje.
- Fat, kërkoje.
- Aventurë, jepu.
- Pasuri, mbaje.



Diskutoj

Diskuto mbi thëniet e Nënë Terezës.



Përralla, gjëegjëza, fjalë të urta

Përralla është një nga format më të përhapura të rrëfimeve gojore. Ajo është një tregim i trilluar plot fantazi me elemente të çuditshme fantastike. Përrallat janë të përhapura në të gjithë botën dhe kanë vlera folklorike.

Përrallat shqiptare shquhen për larmi e fantazi. Në to jepen gjykime për jetën, për të mirën dhe të keqen, për të bukurën dhe të shëmtuarën etj. Përrallat kanë vlera njohëse dhe edukuese.

Gjëegjëzat janë krijime të vogla që kërkojnë përgjigje për një pyetje të bërë në mënyrë të terthortë. Në të shumtën e herës ato kërkojnë të gjendet objekti a sendi për të cilën ato hedhin fjalën.


Në popull gjejmë gjëegjëza nga më të ndryshmet: për njeriun, pjesët e trupit, punët, mjetet e punës, banesën, veshmbathjet, ushqimet, bimët, kafshët, dukuritë e natyrës etj.

Ja një gjëegjëzë për këpucët:

*Kur i lidh ikin,
kur i zgjidh rrinë.*

Për dërrasën e zezë në shkollë:

*Kur është e zezë është e pastër,
kur është e bardhë është e përlyer.*



DISKUTOJ

Me ndihmën e prindërve, kërko dhe sill në klasë disa gjëegjëza.



DETYRË

Bashkë me shokët e shoqet e klasës zgjidhni një nga përrallat shqiptare: “Gishtoja”, “Qerosi”, “E Bukura e Dheut” dhe interpretojeni në klasë.

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve

Fjalë të urta

Fjalët e urta janë thënie të mençura të popullit që përcjellin një mesazh të caktuar.

Disa fjalë të urta shqiptare:

- Ai që s'tutet me fjalë, s'tutet as me pushkë. **Kosovë**
- Atë që të qëllon me gur, mos e qëllo me bukë. **Vlorë**
- Ai që s'ka gojë, vdes pa ardhur dita. **Elbasan**
- Burri një herë ka lerë, një herë do të vdesë. **Kurvelesh**
- Burri o të mbyt, o të fal; i ligu as të mbyt, as të fal. **Shkodër**
- Hidhëroju dikujt, aq sa ka dituri. **Preshevë**
- Ku është besa, aty është dhe shpresa. **Korçë**
- Mos ki frikë nga hasmi, po nga miku i rremë. **Sarandë**
- S'ka qeder shqiponja, nga mushkonjat. **Berat**
- Zogu që i prishet foleja, hidhet degë më degë. **Mat**



Apollonia, Fier




Varri i Gjergj Kastriot Skënderbeut, Lezhë



Diskutoj

Ç'janë përrallat, gjëegjëzat dhe fjalët e urta popullore?



Fjalëshpejta

Fjalëshpejta është një lojë zbavitëse popullore, në të cilën marrin pjesë dy a me shumë veta, që përsëritin sa më shpejt dhe pa gabim fjalë ose fjali të vështira për t'u shqiptuar së bashku.

Këto shprehje popullore provojnë shkathtësinë e të folurit tek njerëzit, në formë loje apo kënge, dhe përdoren pothuajse në të gjithë territorin shqiptar.

Disa fjalëshpejta:

- Kupa me kapak, kupa pa kapak.
- Plepi plak i plasur, pak palcë paska pasur.
- Tre sopata plaka presin tre plepa pleq, plepi më plak ka palcë më pak.
- Karikaturisti karikaturon një karikaturë karakteristike.
- Plaku pllakat suvaton, plaka plakun s'e ndihmon.
- E shes thesin, s'e shes thesin.
- Jemi mbledhur për të mbledhur të pambledhshmit që nuk mblidhen në mbledhje.



Kalaja e Gjirokastrës




Plazhi i Dhërmiut, Vlorë



Diskutoj

Ç'janë fjalëshpejtat? Trego disa prej tyre.

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Festat tradicionale: Dita e Verës

Dita e Verës është një festë me origjinë të lashtë arbëreshe. Ajo festohet çdo 14 mars në Elbasan dhe në gjithë Shqipërinë. Sipas traditës, Dita e Verës simbolizon respektin e nderimin ndaj natyrës dhe veçanërisht ndaj bimësisë që nis e merr jetë.

Në lashtësi konsiderohej si dita e fillimit të vitit kalendarik. Është festë e të gjithë shqiptarëve me veçori nga krahina në krahinë.

Ballokumja është ëmbëlsirë karakteristike e Elbasanit që gatuhet Ditën e Verës. Ajo ka një formulë të veçantë gatimi.



Ballokumja

Rituali i Ditës së Verës kryhet në katër faza:

1. **Faza përgatitore**, grumbullohen ushqimet e festës.
2. **Nata e Verës** nis më 13 mars, me ndezjen e zjarrit.
3. **Mëngjesi i Ditës së Verës** nis me vizitat tek të afërmit, ku djali më i vogël i familjes dërgon dhuratë.
4. **Pikniku i Ditës së Verës**, mbahet në mesditën e 14 marsit.

Karakteristikë janë lulet dhe këngët.



Mëngjesi i Ditës së Verës

 **Diskutoj**

Cilat janë fazat e përgatitjes së Ditës së Verës?



Këngët legjendare shqiptare

Të gjitha këngët legjendare shqiptare tregojnë një ngjarje të rëndësishme, e cila ka të bëjë me fatet e popullit. Nëpërmjet këtyre këngëve, populli shfaq qëndrimin e tij ndaj asaj që tregohet. Këto këngë, të frymëzuara nga ngjarje tregojnë për ngjarje e trimëri të heronjve të jashtëzakonshëm, të quajtur ndryshe kreshnikë.

Populli, këto këngë i quan këngë kreshnikësh.

Figurat kryesore të këngëve të kreshnikëve janë: Muji e Halili, Gjergj Elez Alia, Orët, Zanat etj. Këngët lidhen mes tyre me ngjarje e heronj të njëjtë, por secila prej tyre ka një ngjarje të veçantë e të plotë.

Përveç ngjarjeve historike dhe bëmave të heronjve, në këto këngë përshkruhen edhe: dashuria ndërmjet shokëve, vëllezërve, të rinjve; dashuria prindërore; bukuria e vajzave; gëzimi që jep ardhja e pranverës etj.



Gjergj Elez Alia

Këngëtar i këngëve kreshnike



Diskutoj

Cilat janë figurat kryesore të këngëve legjendare shqiptare?



Heronjtë e këngëve legjendare

Heronjtë kryesorë të këngëve legjendare shqiptare janë: Muji e Halili, Gjergj Elez Alia, Orët, Zanat. Këngët e Mujit e të Halilit këndohen kryesisht në veri të trojeve shqiptare. Në to populli tregon se si është mbrojtur vendi e liria nga armiku; si njerëzit kanë dashur e mbrojtur njëri-tjetrin etj.

Kreshnikët janë malësorë të lirë që jetojnë në bjeshkët e tyre dhe merren me blegtori, bujqësi e gjueti. Ata bëjnë gjithçka që të mbrohen nga të huajt (shkjetë) që sulmojnë trojet e tyre.

*- Po shkjetë në bjeshkë, Muj, na kanë dalë,
Kulla të mira në to i kanë ba,
e po na i hanë bjeshkët pa traminë (pagesë).*



Këngëtarë
të këngëve
kreshnike

Orët dhe Zanat janë gra ose vajza të bukura krijuar nga fantazia e popullit, me fuqi të mbinatyrshme.

Ato jetojnë në bjeshkë dhe ndihmojnë kreshnikët në betejat e tyre, marrin pjesë në fushën e betejës, u shërojnë plagët etj.

Kënga e Gjergj Elez Alisë i këndon trimërisë së heroit Gjergj Elez Alia, i cili mbrojti atdheun dhe nderin e familjes nga i huaji.

Përpjekjet fitimtare të kreshnikut, Gjergj Elez Alia tregojnë për qëndresën popullore kundër përpjekjeve të armiqve për të grabitur lirinë dhe tokat e shqiptarëve.

*...Se ne të parët një kanun na kanë lanë:
Armët me dhanë përpara, e mandej gjanë,
Kurrë Bajlozit, motrën mos me i'a dhanë!...*

Kjo këngë dëshmon se shqiptari:

- E do atdheun dhe bën sakrifica për të.
- E ka të shtrenjtë lirinë e familjen.
- I do fqinjët dhe e respekton lirinë e tyre.



Gjergj Elez Alia



Detyrë

1. Cilat janë disa tipare karakteristike të kreshnikëve shqiptarë?
2. Mëso disa vargje të këngës së Gjergj Elez Alisë.

Trashëgimia kulturore e shqiptarëve



Muzika popullore

Muzika popullore shqiptare ka origjinë të lashtë. Këtë e dëshmojnë vizatimet e gjendura në vazo apo skulptura të ndryshme, të cilat tregojnë figura që janë duke kërcyer apo kënduar.

Këngët popullore shqiptare i këndojnë trimërisë, dashurisë, lindjes së fëmijës, punës dhe shprehin dhimbjen për vdekjen e njerëzve të dashur (vajet), gëzimin e dasmave, trimërinë në luftë etj.

Mënyra e këndimit të muzikës popullore

1. **Këngë që shoqërohen me vegla muzikore.** Këngë të tilla janë ato qytetare, këngë të fshatrave në zonat veriore dhe në Shqipërinë e Mesme.
2. **Këngë që nuk shoqërohen me vegla muzikore.** Këtu futen këngët në grup, me shumë zëra (polifonike), të cilat i gjejmë në Vlorë, Gjirokastër, Tepelenë, Përmet etj..



Grup Polifonik

Në disa krahina polifonia shoqërohet edhe me vegla muzikore, kryesisht në: Delvinë, Përmet, Vlorë, Pogradec, Strugë, Prespë etj.

Kënga me shumë zëra (si iso-polifonia labe) këndohet në mënyrë të organizuar, ku secili ka rolin e tij: **marrësi, kthyesi, hedhësi dhe mbushësi.**

Marrësi – Nis këngën dhe e udhëheq atë.


Kthyesi – Mbështet i pari fjalën e marrësit.

Hedhësi – Rimerr vargun e marrësit dhe e plotëson me zërin e tij në pika kyçe të këngës.

Mbushësi – Mban iso duke qenë brenda tonalitetit të fjalëve të marrësit.



Grupi polifonik



Lahutari



Detyrë

Bashkë me shokët e shoqet e klasës, dëgjo e këndo një këngë polifonike shqiptare.

*Të mësojmë gjuhën amtare
dhe kulturën shqiptare* **1**

